



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 187, Datë 07.08.2025

MBI

**VLERËSIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË
SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SH.A. PËR
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 72, pika 3, gërma “b” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 11 të Programit të Pajtushmërisë së OSSH sh.a., miratuar me Vendimit nr. 257, datë 20.12.2020 të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) “Mbi miratimin e programit të Pajtushmërisë së OSSH sh.a.”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtushmërisë dhe Impaktit Rregullator, me nr. 1426/7 prot., datë 31.07.2025, “Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtushmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh. a., për vitin 2024”,

Konstatohet se:

1. Parashtrimi dhe shqyrtimi i Raportit Vjetor të Pajtushmërisë për vitin 2024

- Në zbatim të nenit 72, pika 3, gërma “b” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020, “Mbi miratimin e Programit të Pajtushmërisë së OSSH sh.a.”, Zyrtari i Pajtushmërisë është ngarkuar të paraqesë çdo vit pranë ERE një raport mbi monitorimin dhe zbatimin e programit përkatës.
- ERE është institucioni përgjegjës për vlerësimin e këtij raporti, si pjesë e funksionit të saj mbikëqyrës mbi pavarësinë funksionale dhe organizative të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

2. Dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit për vitin 2024

- Zyrtari i Pajtushmërisë i OSSH sh.a., i emëruar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.03.2023, ka dorëzuar më datë 26.03.2025 “Raportin vjetor mbi monitorimin dhe zbatimin e Programit të Pajtushmërisë për vitin 2024”.
- Më datë 12.05.2025, pranë ERE është zhvilluar një seancë dëgjimore me Zyrtarin e Pajtushmërisë dhe më pas, me shkresën nr. 1426/5 prot., datë 19.06.2025, është kërkuar informacion shtesë mbi çështje specifike të raportit.

3. Përmbyshja e detyrimeve nga Zyrtari i Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Raporti është dorëzuar në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në Programin e Pajtueshmërisë. Ai është përgatitur në gjuhën shqipe dhe angleze dhe është publikuar në faqen zyrtare të OSSH sh.a.
- Janë përmbyshur detyrimet për raportim mbi ndarjen funksionale dhe organizative të operatorit. Është evidentuar pavarësia e OSSH nga strukturat e tjera të integruara vertikalisht, përfshirë miratimin e një strukture organizative të re nga Këshilli Mbikëqyrës, që garanton ndarjen funksionale dhe vendimmarrje të pavarur.
- Janë zbatuar rekomandimet e mëparshme të ERE dhe janë evidentuar përmirësime në drejtim të transparencës, aksesit në informacion, përfshirjes së platformave online dhe shërbimeve për konsumatorët.

4. Nevoja për përmirësim dhe rekomandime për periudhën pasardhëse

- ERE vlerëson pozitivisht performancën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për vitin 2024, por thekson rëndësinë e:
 - a) Përqendrimit të mëtijshëm në zbatimin e dispozitave të Programit të Pajtueshmërisë.
 - b) Forcimit të mekanizmave të monitorimit mbi proceset kritike si transferimi i punonjësve, zbatimi i projekteve të matësve inteligjentë, funksionimi i platformave për furnizuesit, proceset e ndërrimit të furnizuesit, si dhe përmbyshja e detyrimeve rregullatore për sigurinë kibernetike.
 - c) Raportimit të detajuar mbi vetëprodhuesit, ndikimin në rrjetin e shpërndarjes dhe respektimin e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues të palëve të interesuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Raporti Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “OSSH” sh.a. për vitin 2024. (Bashkëlidhur)
2. Miratimin e Rekomandimeve të ERE-s për vitin 2025, mbi Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. (Bashkëlidhur)
3. Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Impaktit Rregullator, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

RAPORTI I PAJTUESHMËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRDARJES

2024

Mbi masat e zbatuara për implementimin e Programit të Pajtueshmërisë për vitin 2024 në shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Përgatiti:

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë

E-mail: ervis.hazizi@ossh.al

www.ossh.al

Tirane Mars 2025

Përmbajtja

1. HYRJE.....	3
2. MODELI ADMINISTRATIV.....	4
3. MISIONI I SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” OSSH.....	8
4. PROGRAMI I PAJTUESHMERISË OSSH.....	11
5. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE OSSH SH.A.....	17
6. LIBERALIZIMI I TREGUT TE ENERGJISË.....	23
7. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES.....	25
8. KONKURRENCA DHE MARRËDHENIET KOMERCIALE.....	27
9. ZBATIMI I PARIMEVE TË OBJEKTIVITETIT, TRANSPARENCËS DHE PAANSHMËRISË.....	29
10. E DREJTA E INFORMIMIT.....	31
11. POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E SIGURISË KIBERNETIKE.....	34
12. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA.....	35
13. ALOKIMI KOSTOS NË OSSH.....	37
14. ZBATIMI I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË.....	38
15. HUMBJET TOTALE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2024.....	40
16. OPERIMIT DHE ANALIZËS SË RRJETIT SHPËRNDARËS.....	46
17. PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE, REMONTET DHE MIREMBAJTJA E RRJETIT.....	51
18. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRTARIT DHE REKOMANDIMET.....	64
19. BASHKËPUNIMI ME ERE NË LIDHJE ME RAPORTIN E PAJTUESHMËRISË 2023.....	65
20. KONKLUSIONE.....	68

1. HYRJE

Raporti i Pajtueshmërisë për vitin 2024 i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) paraqet një pasqyrë të detajuar të angazhimeve dhe përmbushjes së kërkesave ligjore dhe rregullatore nga ana e shoqërisë, në përputhje me standardet dhe politikat kombëtare të energjisë. Ky raport është një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së OSSH-së dhe transparencës së operacioneve të saj, duke mundësuar një pasqyrë të qartë dhe të besueshme për të gjithë palët e interesuara.

Ky raport hartohet në bazë të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/8 Prot, datë 15.12.2020 të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH Sh.A.). Raporti vjetor hartohet në bazë të detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, Z. Ervis Hazizi (Zyrtari), është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr. 9, date 02.06.2022, "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sh.A."

Në lidhje me zbatimin e programit të pajtueshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OSSH Sh.A. në lidhje me këtë program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij programi. Programi i Pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objektivit dhe transponon në mënyrë të plotë kërkesat e Direktivës 2009/72/EC, në pajtim me Nenin 72 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Gjithashtu, programi përcakton të drejtat dhe detyrimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për të raportuar çdo shkelje të dispozitave ligjore.

Ky raport vjetor hartohet për herë të tretë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH Sh.A.) në lidhje me zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë. Në bazë të Programit të Pajtueshmërisë dhe kontratës që zotëron Zyrtari ka për detyrë hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e Programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Shoqëria OSSH Sha është person juridik shqiptar, e krijuar nga aksionari i vetëm "OSHEE GROUP" Sh.A., bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), në formën ligjore të shoqërisë aksionare, me ofertë private, bazuar në nenin 103 të ligjit nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në korrespondencën dhe aktet e shoqërisë, përfshirë të gjitha shkresat, formularët e urdhërave, çdo publikim, të nxjerra nëpërmjet shkrimit apo formës elektronike që u adresohen palëve të treta, emri/emërtimi i Shoqërisë përmban të dhënat e mëposhme:

- a. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L81530018E;
- b. Emri i Subjektit: OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES;
- c. Data e themelimit: 28/03/2018;
- d. Formën ligjore të përshkruar me fjalë Shoqëri Aksionare ose Sh.A.;

- e. Selinë e saj; të dhëna nëse Shoqëria është në likuidim dhe vlera e kapitalit të regjistruar e shlyer;
- f. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, TIRANË Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

2. MODELI ADMINISTRATIV

Modeli Administrativ është një strukturë e organizuar që pasqyron përputhshmërinë e aktiviteteve të OSSH-së me standardet ligjore dhe rregullative, duke përfshirë angazhimet dhe masat që duhen marrë për të përmbushur këto kërkesa. Ky model administrativ ofron një kornizë të qartë për menaxhimin dhe raportimin e aktiviteteve të OSSH-së, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie për palët e interesuara, si dhe mundësi për vlerësimin e performancës së shoqërisë. për vitin 2024;

2.1 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë, i cili pa paragjykuar kompetencat e tjera të dhëna nga Ligji apo ky Statut, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) përcaktimi i politikave tregtare;
- b) miratimin e strategjisë dhe planeve financiare të Shoqërisë, si dhe të çdo ndryshimi të tyre;
- c) ndryshime të Statutit;
- ç) emërimi, si dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit, nëse nuk përmbushin detyrimet e ngarkuara sipas ligjit dhe statutit;
- d) emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në pikat ç) dhe d);
- e) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecursisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- g) pjesëtimin në pjesë të aksioneve dhe anulimin e tyre; ndryshime në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykime ndaj organeve administrative;
- i) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

- k) vendimet për investime;
- l) çështje të tjera në interes të saj ose sipas parashikimeve të këtij Statuti.
- ll) t'i propozojë Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë mëmë (kontrolluese) strukturë organizative, numrin e përgjithshëm të personelit të shoqërisë së kontrolluar SH.A., strukturën e pagave, nivelet e pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë, kriteret për klasifikim sipas secilit nivel, si dhe ndryshimet e tyre.

2.2 Këshilli i Administrimit OSSH

Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë OSSH Sh.A.:

Erald Hasanaj – Kryetar i emëruar në datë 30.10.2023

Fatjola Halilaj – Anëtare e emëruar në datë 30.10.2023

Bibjana Terolli – Anëtare e emëruar në datë 30.10.2023

Admirim Lakra – Anëtar i emëruar në datë 11.07.2023

Artan Roko – Anëtar i emëruar në datë 28.10.2024.

Gjatë vitit 2024, Këshilli i Administrimit të shoqërisë OSSH Sh.A. ka zhvilluar gjithsej 11 mbledhje dhe ka marrë 23 vendime të rëndësishme, të cilat kanë pasur një rol kyç në progresin e kompanisë. Vendimet e marra janë kontribuar në drejtimin dhe zhvillimin e strategjive afatgjata, duke siguruar përmirësimin e performancës dhe rritjen e efikasitetit në operacione, si dhe në përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli i Administrimit ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin dhe ekzekutimin e politikave që ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin dhe rritjen e kompanisë.

Me Vendimin Nr. 19, datë 28.10.2024, të Asamblesë së Përgjithshme të OSSH SHA, Aksionari i Vetëm ka miratuar zëvendësimin e Anëtarit të Këshillit Administrativ, Z. Mariglen Biti, me Z. Artan Roko. Ky ndryshim do të jetë në fuqi për një mandat 3-vjeçar, i vlefshëm nga data 28.10.2024.

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë së kontrolluar:

- 1) Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e thjeshtë të aksionarëve, bazuar në tagrin e aksionarit të shoqërisë mëmë, bazuar në parashikimet e nenit 207/2 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 2) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit emërohen nga Asambleja me vendim të posaçëm.
- 3) Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit zgjat 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

- 4) Anëtar i Këshillit të Administrimit mund të zgjidhet çdo person sic parashikohet në nenin 156/1 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar apo individ që ka mbaruar arsimin e lartë, zotëron një diplomë të vlefshme në ekonomi, drejtësi, inxhinieri elektrike, menaxhim biznesi dhe që nuk preket nga kufizimet e parashikuara në nenin 156/2 të ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 5) Kryetari i Këshillit të Administrimit kryeson mbledhjet dhe drejton punimet e mbledhjeve, nënshkruan korrespondencën në emër të Këshillit, njofton Këshillin mbi ecurinë e çështjeve të Shoqërisë. Në mungesë të Kryetarit, kompetencat e tij kryhen nga Zëvendës Kryetari.
- 6) Anëtarët e Këshillit të Administrimit përfitojnë pagë bazë dhe shpërblime shtesë për pjesëmarrjen në Këshill.

Bazuar në nenin 163 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në dispozitat e Statutit të shoqërisë OSSH SHA, dhe të Rregullores për funksionimin e brendshëm të Këshillit të Administrimit të shoqërisë, Këshilli i Administrimit të shoqërisë OSSH SH.A. për vitin 2023 ka zhvilluar 4 (katër) mbledhje në të cilat janë marrë 8 (tetë) vendime me karakter ekonomiko-financiar, plan investimesh etj.

Këshilli i Administrimit ka kompetencë:

- a) të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- c) të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecursisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'i paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim edhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit auditues ligjor i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vendoset në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe Administratorit. Raporti i Këshillit

të Administrimit, përmendur në pikën e), duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme shkarkimin / lirimin e Administratorit;

g) të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;

gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

h) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) të miratojë ndryshimet nga plani i miratuar për furnizimin me mallra, shërbime apo shpenzime të tjera;

j) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut;

Këshilli i Administrimit ka detyrimet e parashikuara në Statut dhe nenin 163 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

2.3 Administratori

1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "OSHEE GROUP" Sh.A. me propozim të Këshillit Mbikëqyrës të "OSHEE GROUP" Sh.A. (shoqërisë mëmë) dhe e shkarkohet/lirohet nga Këshilli i Administrimit, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

2. Administrator mund të zgjidhet çdo individ që ka mbaruar arsimin e lartë dhe që nuk preket nga kufizimet e parashikuara në nenin 13/1 dhe 158/2 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

3. Administratori ka këto kompetenca:

a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ja paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;

- d) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - dh) të raportojë përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë;
 - e) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
 - f) Administratori është i detyruar të marrë miratim paraprak nga Asambleja e Përgjithshme dhe/ose Këshilli i Administrimit përpara marrjes dhe/ose zbatimit të ndonjë vendimi në lidhje me çështjet specifike të parashikuara në nenin 12.2 dhe nenin 16,1 h/i /j të këtij Statuti;
4. Detyrat që i cakton ligji e Statuti Këshillit të Administrimit, nuk mund të ushtrohen nga Administratori.
5. Administratori ka detyrimet e parashikuara në Statut, nenin 13 e vijues të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

3. MISIONI I SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” OSSH

OSSH (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) është një shoqëri aksionare e themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri. OSSH ka përgjegjësinë për menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga nenstacionet deri tek konsumatorët përfundimtarë. OSSH ka detyrimin për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetin e shpërndarjes së energjisë, i cili përfshin linjat e tensionit të mesëm dhe të ulët, transformatorët dhe impiantet që lidhin ata me konsumatorët. Aktivitetet e OSSH janë të ndërlidhura me garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike për përdoruesit dhe janë të rregulluara nga autoritetet përkatëse, si Autoriteti i Regullatorit të Energjisë (ERE).

3.1 Shpërndarja e energjisë elektrike;

Referuar Ligjit të Energjisë Nr. 43/2015, i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim aksesin e shpërndarjes së energjisë elektrike e saj të klientët dhe është përgjegjës për:

- Sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
- Përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
- Mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:
- Operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;
- Zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- Lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;
- ç) Siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;
- U siguron përdoruesve të rrjetit informacionin për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes;
- Ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- Siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave;
- Menaxhimi dhe Zhvillimi i Aseteve për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje për konsum të energjië
- Shërbimi për përdoruesit e rrjetit
- Përdoruesit e rrjetit që janë rreth 1,307,000 (familjarë, privatë, buxhetorë, jo-buxhetorë).

3.2 Të drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lidhur me burimet dytësore të energjisë janë si më poshtë:

- Kushtet për instalimin e burimeve dytësore: Sipas nenit 70 të Ligjit Nr. 43/2015, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i takon hartimi i kushteve teknike për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim. Këto kushte miratohen nga (ERE) dhe duhet të sigurojnë që burimi dytësor të përmbushë kërkesat teknike, për të parandaluar çrregullimet në rrjetin e shpërndarjes.
- Njoftimi i klientëve: Çdo klient që dëshiron të instalojë një burim dytësor, duhet të dërgojë një njoftim me shkrim pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Njëkohësisht, ai duhet të sigurojë që përfaqësuesit e furnizuesit të energjisë, me të cilin ka kontratë, të kenë akses në burimin dytësor për inspektimin e instalimit.
- Ndërprerja e furnizimit: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient nëse ky i fundit nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

3.3 Kodi i Shpërndarjes;

Kodi i Shpërndarjes, sipas Neni 73 të Ligjit Nr. 43/2015, përcakton kërkesat teknike dhe proceduriale për planifikimin, zgjerimin, operimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Ai gjithashtu rregullon lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes dhe procedurat e matjes së konsumit të energjisë. Kodi siguron që të gjitha veprimet në sistemin e shpërndarjes të realizohen në

përputhje me standardet dhe rregulloret e vendosura nga Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe të përmbushin kërkesat e sigurisë, efikasitetit dhe transparencës.

- Kodi i Shpërndarjes, sipas nenit 73 të Ligjit Nr. 43/2015, përcakton kërkesat teknike për planifikimin, zgjerimin, funksionimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes. Ai gjithashtu rregullon lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, si dhe procedurat e matjes.
- Miratimi i Kodit: Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, pas propozimit nga Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes. Ky proces bëhet në bashkëpunim me të gjithë aktorët e sektorit të energjisë elektrike, për të siguruar që kodi të jetë i përditësuar dhe i përshtatshëm me zhvillimet e fundit të sektorit.
- Përputhshmëria me Kodin: Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, për të siguruar një operim të sigurt dhe efikas të sistemit të shpërndarjes.

3.4 Verifikimi i matësve;

Verifikimi i matësve të energjisë elektrike është një proces i rëndësishëm për sigurimin e saktësisë dhe besueshmërisë në matjen e konsumit të energjisë. Ky proces është i rregulluar nga Ligji Nr. 43/2015 dhe kodet përkatëse të miratuara nga autoritetet kompetente, siç është ERE. Ja një përmbledhje e aspekteve kryesore të verifikimit të matësve:

- Autoriteti dhe Përgjegjësia: Verifikimi i matësve kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Ky person juridik duhet të jetë i akredituar sipas legjislacionit në fuqi.
- Metoda e Verifikimit: Matësit verifikohen para vënies në përdorim dhe periodikisht, duke përdorur metodën e kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore. Verifikimi mund të bëhet në terren (në vendin e instalimit të matësit) ose në laboratorët përkatës të DPM-së ose institucioneve të autorizuara.
- Kërkesa për Verifikim: Verifikimi mund të realizohet edhe me kërkesë të operatorit të sistemit ose të konsumatorit. Kur klienti ka dyshime për saktësinë e matësit, ai mund të paraqesë një kërkesë me shkrim për verifikimin e tij. Nëse matësi rezulton i saktë, shpenzimet për verifikim mbulohen nga klienti; përndryshe, ato mbulohen nga operatori i sistemit.
- Përfaqësuesi i Operatorit të Sistemit: Gjatë verifikimit të matësve, është e nevojshme që përfaqësuesi i operatorit të sistemit të jetë i pranishëm për të siguruar transparencën dhe për të mbikëqyrur procesin.
- Kostot e Verifikimit: Kostot për verifikimin e matësve para vënies në përdorim dhe gjatë periudhave të verifikimeve periodike mbulohen nga operatori i sistemit. ERE merr në konsideratë këto kosto gjatë miratimit të tarifave përkatëse të energjisë elektrike.
- Ndërrhyrjet e Paligjshme: Në rastet kur operatori i sistemit konstaton ndërrhyrje të paligjshme në matës, ai merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të dëmtuara.

Gjithashtu, bëhen përlogaritje të dëmit ekonomik të shkaktuar nga këto ndërhyrje dhe zbatohen procedurat ligjore përkatëse.

- Miratimi i Tarifave: Tarifat për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët nga Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjinë, bazuar në rregulloret dhe ligjet në fuqi.
- Rregulloret dhe Procedurat: ERE miraton procedurat dhe rregulloret përkatëse që përcaktojnë mënyrën e verifikimit të matësve, si dhe përlogaritjen e dëmeve nga ndërhyrjet e paligjshme.

Verifikimi i matësve ka një rol të rëndësishëm në sigurinë e të dhënave dhe në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke siguruar që matjet e energjisë të jenë të sakta.

4. PROGRAMI I PAJTUESHMERISË OSSH

Programi i Pajtueshmërisë i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH Sh.A.) është një instrument thelbësor për sigurinë dhe menaxhimin e operacioneve të kompanisë në përputhje me legjislacionin dhe standardet e sektorit të energjisë elektrike. Ky program ka si qëllim të sigurojë që OSSH të veprojë me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri, duke ndaluar çdo veprim diskriminues dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorëve, si dhe duke siguruar një mjedis të rregullt dhe të përshtatshëm për zhvillimin e shërbimeve të shpërndarjes së energjisë.

4.1 Dispozita të përgjithshme

Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH Sh.A.) ka si qëllim përcaktimin e kushteve për ndarjen dhe pavarësinë e këtij operatori, në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe amendimet e tij. Ky program është krijuar për të shmangur praktikat diskriminuese të mundshme nga ana e OSSH Sh.A., veçanërisht ndaj shoqërive bijë të këtij operatori, dhe për të siguruar mekanizma të zbatimit, monitorimit dhe raportimit të tij.

Programi përcakton obligimet e specifikuar të punonjësve dhe mbështet implementimin e plotë të kërkesave të Direktivës 2009/72/EC, në përputhje me Nenin 72 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Ky program është miratuar nga Këshilli i Administrimit të OSSH Sh.A. me vendimin nr.18/2020. Në datën 11 dhjetor 2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përmes komunikimit elektronik, dërgoi komentet dhe sugjerimet lidhur me këtë program, të cilat, sipas OSSH Sh.A., janë reflektuar në pjesën më të madhe të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të cilat janë reflektuar në Programin e Pajtueshmërisë, konsistojnë në:

- Referimin më qartë të qëllimit të Programit për të shmangur sjelljen diskriminuese në favor të kompanive bija të OSSH Sh.A.;

- Vendosjen e një detyrë eksplicite ndaj Zyrtarit të Pajtueshmërisë sa i përket identifikimit të rasteve kur stafi është duke punuar njëkohësisht në më shumë se një kompani, apo është në konflikt (interesi);
- Të drejtën e aksesit të Zyrtarit në të gjithë të dhënat e rëndësishme të shoqërisë, të përfshihet në mënyrë të qartë në Program;
- ç) Nxjerrjen e rekomandimeve dhe udhëzimeve të brendshme nga ana e Zyrtarit;
- Punonjësit (e OSSH Sh.A.) jo vetëm të deklarojnë gatishmërinë për të implementuar Programin e Pajtueshmërisë, por ky i fundit duhet të jetë detyrues për ta;
- dh) Në të drejtat e punonjësve duhet të përfshihet e drejta për të adresuar tek Zyrtari çdo informacion lidhur me diskriminimin potencial, në mënyrë anonime;
- Përmbytja e Programit Vjetor të përkufizohet më në detaje;
- ë) Aksesit në informacion dhe përjashtimi nga çdo privilegj (lidhur me informacionin) i kompanive bija në biznesin konkurrues duhet të adresohet në më shumë detaje;
- OSSH Sh.A., si një kompani me të drejtë ekskluzive duhet të prokurojë të gjithë mallrat dhe shërbimet përmes një procedurë konkurruese. Në rastet e ndonjë të mirë apo shërbimi të prokuruar brenda kompanisë, pa një procedurë publike prokurimi, këto të mira apo shërbime do të vlerësohen me çmim tregu ose në kosto, cilado (prej tyre) është më e ulët;
- Sa i përket sanksioneve disiplinore në nivelet menaxheriale dhe për të gjithë punonjësit e OSSH Sh.A., Programi i Pajtueshmërisë duhet të përfshijë pasoja shitesë/më të detajuara.

Në veçanti ky program ka si qëllim të sigurojë:

- Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OSSH;
- Ndarjen e llogarive, menaxhimit, dhe vendimmarrje të plotë sipas ligjit 43/2015;
- Shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH ndaj përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes;
- Transparencë dhe paanshmëri;
- Monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi në ERE;
- Përgatitja e raportit vjetor të detajuar.

4.2 Transpozimi i kërkesave të Direktivës 2009/72/EC:

Në vitin 2024, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e Direktivës 2009/72/EC, OSSH (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) ka ndërmarrë disa masa dhe veprime në përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara në këtë direktivë. Direktivës 2009/72/EC i vendos kërkesa të qarta për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike dhe për garantimin e shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët. Ja disa nga masat që OSSH mund të ketë zbatuar për vitin 2024:

Sigurimi i Furnizimit të Pandërprerë me Energjisë Elektrike;

- Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Investimet: OSSH ka mundësuar investime në rrjetin e shpërndarjes, për të mundësuar një furnizim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike.

Këto përfshijnë mirëmbajtjen dhe rinovimin e infrastrukturës ekzistuese, si dhe zgjerimin e kapaciteteve të shpërndarjes për të trajtuar kërkesat në rritje.

- Plani për Trajtimin e Ndërprerjeve dhe Emergjencave: OSSH ka zhvilluar dhe implementuar strategji për menaxhimin e ndërprerjeve të furnizimit, përfshirë përmirësimin e sistemeve të alarmit dhe rikuperimin e shpejtë në rast emergjence. Kjo ndihmon në rikthimin e shërbimit sa më shpejt të jetë e mundur pas çdo ndërprerjeje të pa-planifikuar.

Përmirësimi i Shërbimeve të Cilësisë së Lartë për Konsumatorët;

- Monitorimi i Cilësisë së Shërbimit: OSSH ka implementuar sisteme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së energjisë elektrike që shpërndahet në rrjet, duke siguruar që ajo të përmbushë standardet e përcaktuara në Direktivën 2009/72/EC për parametrat e cilësisë, si tensioni, frekuenca dhe ndërprerjet.
- Menaxhimi i Ankesave: OSSH ka përforcuar proceset e menaxhimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Kjo përfshin trajtimin e ankesave për cilësinë e furnizimit me energji, si dhe garantimin e një reagimi të shpejtë dhe efikas për çdo problem që mund të ndodhi.
- Shërbimi ndaj Klientëve dhe Call Center: OSSH ka përmirësuar shërbimet ndaj klientëve përmes Call Center-it, duke ofruar mundësi për konsumatorët që të regjistrojnë kërkesat dhe ankesat e tyre. Po ashtu, janë ofruar mundësi për ndihmë përmes kanaleve të tjera të komunikimit (online, e-mail, etj.).

Përputhshmëria me Kërkesat për Informacion dhe Transparencë;

- Raportimi i Rregullt tek ERE dhe Palët e Interesuar: OSSH ka ofruar raporte të rregullta për ERE dhe për konsumatorët lidhur me cilësinë e furnizimit, duke përfshirë informacionin mbi çdo ndërprerje, nivelin e tensionit, frekuencën dhe përpjekjet për përmirësim.

Siç u theksua më sipër, OSSH ka ndërmarrë një sërë masash për të siguruar një furnizim të pandërprerë me energji elektrike dhe për të garantuar shërbime të cilësisë së lartë për konsumatorët. Në përpjekje për të maksimizuar efikasitetin dhe për të minimizuar problematikat, kompania vazhdon të bëjë investime të rëndësishme në infrastrukturën e shpërndarjes. Këto investime kanë për qëllim përmirësimin e rrjetit dhe sigurinë e furnizimit, duke u mundësuar konsumatorëve një shërbim më të besueshëm dhe pa ndërprerje.

Megjithatë, OSSH pranon se ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në zonat rurale. Aty, ku infrastruktura mund të jetë më e vjetruar (amortizuar) dhe ku ka kërkesa të ndryshme për furnizim me energji, kompania është e angazhuar të implementojë zgjidhje inovative dhe efikase. Kjo do të kontribuojë në optimizimin e shpërndarjes dhe do të reduktojë mundësinë e ndodhisë së ndërprerjeve të pa-planifikuara, duke siguruar që çdo konsumator të ketë qasje në energjinë elektrike të cilësisë së lartë dhe të qëndrueshme.

4.3 Raporti i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për Vitin 2023

Në përputhje me angazhimin për transparencë dhe përgjegjshmëri, Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE) ka publikuar raportin e pajtueshmërisë për vitin 2023, duke siguruar informacion të detajuar për

performancën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Ky raport është një reflektim i përpjekjeve të OSSH-së për të ofruar një shërbim të sigurt dhe të qëndrueshëm në shpërndarjen e energjisë elektrike, duke monitoruar dhe vlerësuar plotësimin e standarteve të caktuara për cilësinë e shërbimeve dhe rregullat e përcaktuara nga ERE.

Për më shumë informacion dhe akses në raportin e plotë, mund të vizitoni faqet zyrtare të ERE-së (www.ere.gov.al) dhe OSSH-së (www.ossh.al), ku janë publikuar të dhënat e plota të raportit të pajtueshmërisë për vitin 2023. Ky dokument ofron një pasqyrë të hollësishme mbi përpjekjet e OSSH-së për të rritur efikasitetin e sistemit të shpërndarjes dhe për të siguruar që energjia të arrijë në çdo shtëpi dhe biznes me siguri dhe cilësi të lartë.

4.4 Vlerësimet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për OSSH

Më 9 prill 2024, Drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, prezantoi Raportin e Zbatimit për Shqipërinë për vitin 2023. Në këtë raport, u theksuan arritjet e Shqipërisë në reformat e tregut të energjisë, përfshirë ndarjen e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë (OSSH) dhe mbylljen e çështjes së shkeljes ECS-04/17.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është ligjërish dhe funksionalisht i ndarë, në përputhje me rregulloret dhe kërkesat e përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Gjithashtu, Sekretariati i Energjisë ka kërkuar që Kodi i Shpërndarjes të rishikohet, duke marrë parasysh faktin që ky kod është në fuqi që nga viti 2008 dhe kërkon përditësime për të pasqyruar zhvillimet dhe ndryshimet e nevojshme në tregun e energjisë.

OSSH SHA, si anëtare e grupit ECDSO-E (Energy Community Distribution System Operators Coordination), mban kontakte të vazhdueshme me këtë grup pune përmes E-mail, pjesëmarrjes aktive në diskutime dhe aktivitete që përfshijnë sektorë të ndryshëm të industrisë së energjisë. Çdo sektor ka një përgjegjësi të caktuar, i cili kontribuon në menaxhimin dhe zhvillimin e çështjeve që ndikojnë në operimin e sistemeve të shpërndarjes.

Ky grup pune bashkëpunon për të adresuar çështje strategjike dhe të rëndësishme, duke përfshirë menaxhimin e disbalancave të energjisë, përcaktimin e tarifave të shërbimeve, uljen e humbjeve në rrjet, si dhe përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të shërbimeve. Shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira ndërmjet shteteve të rajonit është një komponent thelbësor i këtij bashkëpunimi, duke mundësuar që anëtarët e grupit të ndajnë mësimet të vlefshme dhe të përmirësojnë proceset dhe procedurat në organizatat e tyre.

Në këtë kuadër, OSSH SHA ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme duke ofruar informacion dhe analiza mbi progresin e arritur çdo vit, duke theksuar zhvillimet dhe përmirësimet në menaxhimin e disbalancave të energjisë dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të shpërndarjes. Ky bashkëpunim ka mundësuar gjithashtu zhvillimin e strategjive dhe zgjidhjeve inovative për menaxhimin e tarifave të rrjetit dhe përmirësimin e

shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke siguruar përputhshmërinë me rregulloret dhe direktivat ndërkombëtare.

Ky proces ka krijuar mundësi të vlefshme për të diskutuar praktikat më të mira dhe për të zhvilluar politika të përbashkëta që kontribuojnë në efikasitetin e përgjithshëm të sistemeve të shpërndarjes dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimit për konsumatorët.

4.5 Koordinimi i Projektit për Rishikimin e Kodit të Shpërndarjes

Në vitin 2024, OSSH/OSHEE ka nisur një projekt të rëndësishëm për rishikimin dhe përmirësimin e Kodit të Shpërndarjes, me qëllim përditësimin e tij në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e energjisë dhe kërkesat e tregut. **Ky rishikim përfshin dispozita të reja dhe të përmirësuara që adresojnë nevojat e vetë-prodhuesve, mjeteve elektrike dhe ruajtjes së energjisë, që janë elemente kyçe për një rrjet të qëndrueshëm dhe efikas.**

Drafti përfundimtar i Kodit të Shpërndarjes është aktualisht në fazën e shqyrtimit nga OSSH/OSHEE, përpara se të kalojë në fazën e dëgjësive publike, të cilat do të organizohen nga Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE). Ky proces i rëndësishëm synon të sigurojë përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe të marrë sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të kodit, përpara se të miratohet dhe të implementohet.

Priten hapat e fundit të procesit, dhe ky dokument do të bëhet në dispozicion për publikun dhe për sektorin e energjisë në një afat të arsyeshëm, duke u siguruar që të gjithë aktorët përkatës janë të informuar dhe të përgatitur për aplikimin e tij.

4.6 Detyrat e Zyrtarit të Pajtueshmërisë;

Me vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), caktohet Zyrtari i Pajtueshmërisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat e Programit të Pajtueshmërisë dhe për paraqitjen e Raportit të Pajtueshmërisë pranë ERE-së.

Zyrtar ka rolin kryesor në monitorimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe rregullative të programit, si dhe përditësimin e tij në përputhje me nevojat e ndryshimeve apo rishikimeve të mundshme, duke kërkuar miratimin paraprak të ERE-së.

Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe nuk mund të mbajë, as direkt dhe as indirekt, asnjë pozicion ose interes profesional në kompani të cilat janë të vertikalisht të integruara. Ky angazhim është thelbësor për të siguruar se Zyrtari i Pajtueshmërisë mund të kryejë detyrat e tij në mënyrë objektive dhe pa ndikime të jashtme.

Raportimi dhe Monitorimi: Zyrtari i Pajtueshmërisë ka përgjegjësinë për të raportuar çdo rast ku stafi i OSSH Sh.A. është i angazhuar në më shumë se një kompani të ngjashme në të njëjtën kohë, ose kur ka ndodhur një konflikt interesi. Për këtë qëllim, Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të sigurojë që këto raste të identifikohen dhe të adresohen në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.

Pjesëmarrja në Mbledhje dhe Aksesit në Informacion: Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe të menaxhimit të OSSH Sh.A. nëse ai e vlerëson se pjesëmarrja e tij do të kontribuonte në realizimin e detyrave të tij, veçanërisht në lidhje me çështje të tilla si:

- Kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes.
- Përdorimi i rrjetit të shpërndarjes dhe alokimi i kapaciteteve të tij.
- Transparenca dhe zhvillimi i projekteve për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes.
- Blerja dhe shitja e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjet.

Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka gjithashtu të drejtën të ketë akses në të gjitha të dhënat që ai vlerëson si të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, përfshirë të dhënat e OSSH Sh.A. dhe të shoqërive bijë, në përputhje me standardet e transparencës dhe të sigurisë.

Raportimi dhe Propozimet për Masat Korrektuese: Nëse Zyrtari i Pajtuëshmërisë identifikon ndonjë problematikë në implementimin e Programit të Pajtuëshmërisë, ai është përgjegjës për të përgatitur dhe paraqitur masat dhe propozimet e tij për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Ky proces mund të përfshijë përgatitjen e rekomandimeve për udhëzime të brendshme dhe, kur e kërkon rasti, mund të përfshijë përgatitjen e masave disiplinore.

Nëse problemi nuk adresohen brenda një afati të arsyeshëm, Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka detyrimin të raportojë pranë ERE-së. Ky raportim do të realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke siguruar që ERE të ketë informacion të plotë dhe të saktë për çdo shkelje të mundshme të Programit të Pajtuëshmërisë.

Pavarësia në Raportim dhe Veprim: Për shmangie të çdo dyshimi, asgjë në këtë dispozitë nuk nënkupton që Zyrtari i Pajtuëshmërisë është i varur nga Këshilli i Administrimit ose stafi menaxherial i OSSH Sh.A. Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka të drejtë të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të raportojë direkt pranë autoritetit rregullator për çdo shkelje të mundshme të Programit, duke i mbajtur gjithashtu të informuar menaxherët e OSSH Sh.A. për këtë proces.

Ky sistem është i ndërtuar për të siguruar që Programi i Pajtuëshmërisë të zbatohet në mënyrë efektive dhe të paanshme, duke ofruar mbikëqyrje të rreptë dhe duke promovuar një kulturë të përgjegjësisë dhe transparencës brenda OSSH Sh.A.

4.7 Metodologjia e kontrollit të Programit nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë OSSH Sh.A. do jetë e tillë:

Zyrtari i Pajtuëshmërisë do të përdorë një metodologji të strukturuar për të kontrolluar zbatimin e Programit të Pajtuëshmërisë, duke përfshirë këto hapa kryesorë:

- Mbledhja e Informacionit: Zyrtari do të mbledhë të dhënat e nevojshme përmes dokumenteve shkresore, email-eve dhe të dhënave të tjera të brendshme të OSSH Sh.A.
- Verifikimi i Dokumentacionit dhe Ankesave: Zyrtari do të shqyrtojë dokumentet e brendshme, ankesat dhe kontratat për të siguruar përputhshmërinë me Programin e Pajtuëshmërisë.

- Pjesëmarrja në Mbledhjet: Zyrtari do të marrë pjesë në mbledhjet e drejtuesve dhe organeve të OSSH Sh.A., përfshirë Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin Mbikëqyrës dhe njësitë drejtuese, për të siguruar që vendimet janë në përputhje me programin.

Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar një mbikëqyrje të plotë dhe të paanshme, duke ndihmuar në shmangien e sjelljeve diskriminuese dhe sigurimin e përputhshmërisë me ligjin.

5. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE OSSH SHA

Në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka ndërmarrë një proces të rëndësishëm ndarjeje ligjore, funksionale dhe financiare lidhur me aktivitetin e tij. Ky proces ka siguruar që OSSH të operojë si një shoqëri e pavarur nga aktivitetet e tjera të licencuara të grupit OSHEE, duke përmbushur kështu kërkesat ligjore për të siguruar pavarësinë e funksionimit të tij, veçanërisht lidhur me shpërndarjen e energjisë elektrike.

Pavarësia e OSSH-së është e garantuar në përputhje me nenin 72 të Ligjit Nr. 43/2015, i cili parashikon se OSSH ka të drejta të plota vendimmarrëse dhe është i pavarur nga shoqëria OSHEE Group SH.A. në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes. Ky sistem operativ i pavarur është thelbësor për të siguruar integritetin dhe efikasitetin e shërbimit të shpërndarjes për konsumatorët dhe për të plotësuar kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Marrëdhënia me Shoqërinë Vertikalisht të Integruar

Marrëdhënia e OSSH me shoqërinë OSHEE Group SH.A., e cila është një shoqëri vertikalisht e integruar, është e pasqyruar në statutin e OSSH SH.A., në nenin 25, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e ndarjes dhe pavarësisë. Pika 25.1 e statutit parashikon që OSSH ka të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga OSHEE Group SH.A., lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe hartimin e programit të pajtueshmërisë.

Ky program i pajtueshmërisë ka si objektiv të sigurojë ndalimin e veprimeve diskriminuese dhe të garantojë se çdo veprim do të monitorohet dhe përmbushë kërkesat e përcaktuara ligjore dhe rregullatore, duke rritur sigurinë dhe transparencën në operacionet e OSSH. Ky program përcakton gjithashtu detyrimet specifike të punonjësve për të siguruar zbatimin e tij të duhur.

Në përputhje me nenin 25.2 të statutit, personat përgjegjës për menaxhimin e OSSH-së nuk duhet të marrin pjesë në strukturat drejtuese të shoqërisë OSHEE Group SH.A. lidhur me aktivitetet operative të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike, për të ruajtur pavarësinë dhe integritetin e menaxhimit të OSSH.

Në përputhje me statutin dhe ligjin, administratori i shoqërisë OSHEE Group SH.A. nuk mund të vendosë kufizime ndaj tagrave dhe kompetencave të administratorit të OSSH SH.A. dhe nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operationale të OSSH, përfshirë vendimet lidhur me ndërtimin

dhe rikonstrukcionin e linjave të shpërndarjes. Kjo ndihmon në sigurimin e një administrimi të pavarur dhe të paanshëm për sistemin e shpërndarjes.

Në përputhje me nenin 25.5 të statutit, OSHEE Group SH.A. ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale të OSSH, përmes Këshillit të Administrimit dhe strukturave të tjera, duke mbajtur një kontroll të përgjithshëm mbi krijimin e kapitalit dhe miratimin e planit ekonomik financiar, si dhe mbi kufizimin e borxhit të OSSH. Ky kontroll është në përputhje me rregullat e përcaktuara për mbikëqyrjen ekonomike dhe menaxheriale të shoqërisë, duke siguruar një menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent.

5.1 Ndarja ligjore

OSSH i plotëson kërkesat e “Programin e Pajtueshmërisë” pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kane lidhje me Furnizimi e Shpërndarjes Universale (FSHU) dhe Furnizimi I Tregut të Lire (FTL) dhe është në përputhje me Ligjit të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin. Gjithashtu, OSSH është një person juridik i ndarë që është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara OSHEE GROUP.

Ndarja ligjore u përgatit në vitin 2019 dhe u krye menjëherë në fillim të vitit 2020 kur shoqëria filloi të funksionojë si një e vetme me të drejta të plota vendimarrjeje në zbatim të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në fillim të vitit 2020 shoqëria aprovoi me vendim të veçantë “Programin e Pajtueshmërisë”, i cili synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH Sh.A. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

- të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.
- të hartojë dhe të depozitojë në organet kompetente një program vjetor të detajuar.

5.2 Ndarja funksionale

Ndarja funksionale lidhet me procesin e ndarjes së asetëve dhe detyrimeve nga shoqëria mëmë dhe sigurimin e përdorimit funksional të tyre, në shërbim të realizimit të objektivave të shoqërisë, i cili ishte një proces më i gjatë dhe më i ndërlikuar, që kërkoj shumë vendime organizative dhe kohë të implementimit. Veçanërisht ndarja e të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë sipas pasqyrës së bilancit, që u shoqërua me analiza të hollësishme të të dhënave të rregjistruara dhe të një metodologjie të veçantë të ndarjes, kërkoj një kohë më të madhe duke u shtrirë pothuajse gjatë gjithë vitit 2020.

Ky proces kishte të nevojshëm gjithashtu edhe ndryshime në skemën organizative të shoqërisë për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të menaxhimit dhe administrimit, për të theksuar që shoqëria është në transformim të vazhdueshëm dhe përshtatje më të mira funksionale janë objekt i vendimmarrjeve në vazhdim.

Vlerësimi i ndarjes nëpërmjet transferimit të aktivitetit të shoqërisë u krye nga Auditorët Ligjorë të Pavarur (I.L.D-99 Audit) sipas raportit të paraqitur në datën 10/12/2020.

“Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, si dhe të Urdhrit të Aksionerit të “OSHEE” sh.a. Nr. 157, datë 12.02.2018, mbi “Krijimin e tri shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, janë themeluar tri shoqëritë bija:

- **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A. (OSSH Sh.A.)** me ofertë private, me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë;
- **Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A. (FSHU Sh.A.)** me ofertë private, me objekt aktiviteti në furnizimin me energji elektrike të klienteve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë;
- **Furnizuesi i Tregut të Lirë Sh.A. (FTL Sh.A.)** me ofertë private, me objekt aktiviteti në blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.

Për rrjedhojë, në kuadër të bërjes efektive të ndarjes si dhe në zbatim të nenit 138 e vijues të Kodit të Punës, janë njoftuar të gjithë punonjësit se duke filluar nga data 01.01.2020 marrëdhëniet e tyre të punës transferohen nga punëdhënësi aktual “OSHEE” Sh.A. te punëdhënësi i ri “OSSH” Sh.A. me të njëjtat kushte kontraktore. Departamenti i Burimeve Njerëzore është ngarkuar për të ndjekur e për të njoftuar lidhur me vijimësinë e marrëdhënies së punës.

Në këtë aspekt, nga ana ime do të monitorohen të gjitha emërimet dhe transferimet nga stafi OSHEE në OSSH, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe transparencën që ne do të ofrojmë me punonjësit.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në OSHEE GROUP Sh.a. operon në përputhje me legjislacionin dhe aktet ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- Ligji nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- Kodi i Punës, Ligji nr. 7961/1995
- Ligji nr. 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore”
- Ligji nr. 10237/2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”
- Ligji nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- Ligji nr. 9367/2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”
- Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”
- Ligji nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”

Vendime dhe rregullore:

- Vendimi nr. 997/2010 i Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve jashtë qendrës së punës”
- Rregullorja dhe statutet e OSHEE GROUP SH.A. dhe shoqërive nën të.


Marrëveshje shërbimesh:

- Marrëveshje ndërmjet OSHEE GROUP Sh.A. dhe OSSH Sh.A., FTL Sh.A., FSHU Sh.A.

Politikat e Burimeve Njerëzore në OSHEE Group Sh.a. kontribuojnë në krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm dhe në zhvillimin e një kulture organizative pozitive, duke rritur angazhimin dhe produktivitetin e punonjësve. Disa nga politikat kryesore janë:

- Rekrutimi dhe Përzgjedhja: Politikat për rekrutimin e kandidatëve të rinj dhe kriteret për intervistat dhe përzgjedhjen e tyre.
- Trajnimi: Udhëzime për trajnime fillestare dhe mundësi për zhvillimin profesional të punonjësve.
- Vlerësimi i Performancës: Procedurat për vlerësimin e performancës së punonjësve.
- Kompensimi dhe Përfitimet: Rregullat për pagat, bonuset dhe përfitimet e tjera për punonjësit.
- Kodi i Punës dhe Praktikrat Kundër Diskriminimit: Respektimi i ligjeve të punës dhe mbrojtja nga diskriminimi në vendin e punës.
- Pushimet dhe Lejet: Rregullat për pushimet e paguara dhe lejet për arsye personale dhe mjekësore.
- Menaxhimi i Konfliktëve: Procedurat për zgjidhjen e konflikteve mes punonjësve ose mes punonjësve dhe menaxhmentit.
- Etika dhe Sjellja në Punë: Kodet e sjelljes për komunikimin dhe sjelljen në vendin e punës.
- Siguria dhe Shëndeti në Punë: Politikat për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, përfshirë masat për parandalimin e aksidentëve dhe sëmundjeve.

5.5 Organigrama



Struktura e re organizative e propozuar dhe e miratuar nuk parashikon ndryshime në numrin total të punonjësve të shoqërisë, i cili mbetet i pandryshuar (1+5837). Ajo ka për qëllim riorganizimin e Shoqërisë në përputhje me zhvillimet e Tregut të Energjisë Elektrike dhe optimizimin e menaxhimit të proceseve të punës në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes Sh.a.

6. LIBERALIZIMI I TREGUT TE ENERGJISË

Në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe Nenet 86 dhe 109, që parashikojnë daljen e detyrueshme në tregun e liberalizuar për të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike të lidhur në tension të mesëm (35/20/10/6 KV), OSSH Sha ka ndjekur dhe zbatuar këtë proces në mënyrë të drejtë dhe transparente, pa diskriminuar asnjë furnizues të licencuar apo konsumator të energjisë elektrike. Ky proces ka filluar në vitin 2018, kur konsumatorët e lidhur në rrjetin 35KV kanë nisur të furnizohen në treg të lirë.

Në përputhje me Urdhërrëfimin Nr. 28/2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), “Për Miratimin e Udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, faza finale e këtij procesi ka përfshirë ndryshimin e furnizuesit për të gjithë konsumatorët, përveç atyre të lidhur në tension të ulët (0.4 KV).

Për këtë arsye, nga 1 janar 2022, të gjithë përdoruesit e rrjetit të tensionit të mesëm 20/10/6 KV të OSSH Sha janë furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, me mundësinë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre në treg të lirë brenda afatit dyvjeçar të përcaktuar nga Ligji Nr. 43/2015. Ky ndryshim ka prekur gjithsej 7,350 konsumatorë, nga të cilët 1,013 janë nga sektori publik, ndërsa pjesa tjetër nga sektori privat. Me përfundimin e periudhës dyvjeçare të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë miratoi me Urdhërin Nr. 217/2023, datë 29.12.2023, disa ndryshime në Udhërrëfyesin për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike. Sipas këtyre ndryshimeve, nga 1 janari 2024, konsumatorët e lidhur në tension të mesëm 20KV nuk mund të furnizohen më nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Si pasojë, 2,145 konsumatorë të energjisë elektrike të lidhur në tension të mesëm 20KV kanë filluar të furnizohen nga Furnizuesi i Tregut të Lirë Sh.a., duke realizuar kështu një tjetër hap në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë.

Në tabelën e mëposhtme po ju paraqesim një historik të situatës së furnizimit në treg të lirë për periudhën 2018-2024, të konsumatorëve 35/20 KV.


VITI	UN	NR KONSUMATORE	KONSUMI VJETOR MWH
2018	35KV	16	14,687
2019	35KV	34	41,209
2020	35KV	67	66,712
2021	35KV	68	82,851
2022	35KV	71	50,607
2023	35KV	76	44,313
2024	35KV	95	61,707
2024	20KV	2145	417,094

Gjatë vitit 2024, rreth 8% e konsumit total të energjisë shpërndarë përmes rrjetit të shpërndarjes është përdorur për furnizimin e konsumatorëve të lidhur në tension të mesëm. Ky konsum ka arritur në 478,801

MWh, ku 6% e tij është furnizuar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë Sh.a. (FTL SH.A.), ndërsa pjesa tjetër është furnizuar nga furnizuesit privatë të licencuar.

Po ashtu, duke krahasuar konsumin total të furnizuar në tregun e liberalizuar, rezulton se 73% e këtij konsumit është siguruar nga FTL SH.A., ndërsa 27% është furnizuar nga furnizuesit e tjerë.

KONSUMI %



FSHU FMF FTL TE TJERE

TREGU I LIRE



FTL FURNIZUES TE TJERE

Gjatë vitit 2024, pranë OSSH Sha janë regjistruar rreth 300 kërkesa nga konsumatorët dhe furnizuesit privatë të licencuar për ndryshimin e furnizuesit, sipas Rregullores për Ndryshimin e Furnizuesit të Energjisë. Për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave dhe për t'iu përmbushur kërkesave të tregut të energjisë dhe balancimit, OSSH Sha ka ndërmarrë masa të nevojshme për pajisjen e konsumatorëve me matës inteligjentë. Këta matës transmetojnë të dhënat orare të matjes në platformën Data/Center (AMI) të menaxhuar nga OSSH Sha dhe ndajnë këtë informacion në bazë ditore me Furnizuesit e Energjisë Elektrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Tregut.

Me fillimin e furnizimit të konsumatorëve të lidhur në rrjetin 10 KV në tregun e liberalizuar, nga data 01.01.2025, me një total prej rreth 2,500 konsumatorësh, që do të furnizohen për herë të parë në një treg të derregulluar, parashikohet një rritje e numrit të kërkesave për ndryshimin e furnizuesit. Kjo sjell nevojën për përmirësimin e menaxhimit të këtij procesi nga OSSH Sh.a., me fokus në zbatimin e “Rregullores për Ndryshimin e Furnizuesit”, ruajtjen e afateve ligjore, lehtësimin e procedurave për dorëzimin e dokumentacionit dhe monitorimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të përfshira në këtë proces.

Në këtë kuadër, OSSH Sha, në bashkëpunim me DIT/OSHEE GROUP Sha, ka punuar gjatë dy viteve të fundit për zhvillimin e një platforme të menaxhimit të procesit të ndryshimit të furnizuesit. Kjo platformë do të përdoret nga të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike të licencuar që operojnë në tregun e liberalizuar, duke mundësuar ndërveprimin në kohë reale

Furnizuesit e licencuar të energjisë elektrike që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Sigurimit të Shërbimit të Shpërndarjes me OSSH Sh.A. dhe janë kualifikuar për të furnizuar konsumatorët në tregun e lirë të energjisë elektrike, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, janë si në vijim:

1. GSA ShPK
2. Kurum International ShA
3. Albania Energy Supplier ShPK
4. Energy Gas and Power Albania ShPK
5. Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL ShA)
6. EZ-5 Energy ShPK
7. Noa Energy Trade ShPK
8. Ener Trade ShPK
9. ALB Trading and Consulting ShPK
10. H&K @ Vala Mar Rezidences ShPK
11. Grind Energy

7. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES

Kyçja në sistemin e shpërndarjes është një proces që mundëson lidhjen e përdoruesve me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike në mënyrë të sigurt, efikase dhe të drejtpërdrejtë. Ky proces përfshin instalimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme, dhe është mbikëqyrur nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për të siguruar që tarifat dhe shërbimet të jenë të drejta dhe të justifikueshme për çdo përdorues. OSSH është i detyruar të sigurojë që kyçja të ndodhi pa asnjë formë diskriminimi, duke garantuar që të gjithë përdoruesit të kenë mundësi të barabarta dhe të drejta për të lidhur me rrjetin dhe për të përdorur energjinë elektrike.

Në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", një nga parimet thelbësore të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është siguri i barazisë dhe shmangia e çdo forme të diskriminimit në veprimet e OSSH dhe ndërveprimet me konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara. Programi i Pajtueshmërisë synon të sigurojë që të gjitha vendimet dhe veprimet

e ndërmarrë nga OSSH të jenë të drejta, transparente dhe të paanshme, pa ndikuar ndonjëherë nga interesa të paligjshme, politike apo komerciale.

Për të eliminuar sjelljen diskriminuese ndaj përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes, përfshirë konsumatorët dhe burimet e prodhimit të energjisë që janë lidhur në rrjetin elektrik të OSSH (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) zbaton disa rregulla dhe udhëzime si më poshtë:

- **Mbrojtja nga diskriminimi në ofrimin e shërbimeve:** OSSH siguron që të gjithë konsumatorët dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Ky parim është esencial për të garantuar që asnjë konsumator të mos diskriminohet në lidhje me furnizimin me energji elektrike, përfitimin e shërbimeve, apo ndërveprimet me sistemin, duke u bazuar në kriteret e padrejta të tilla si statusi social, grupe etnike, raciale, gjinore apo politik.
- **Tarifat e Drejta dhe të Barabarta:** Përcaktimi i tarifave dhe pagesave në një mënyrë që të jenë të drejta dhe të barabarta për të gjithë përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH, duke u bazuar në kostot e vërteta të shërbimeve të ofruara nga ana e saj.
- **Transparenca:** Sigururon transparencën së plotë në procesin e përcaktimit të tarifave dhe politikave të tjera, duke përfshirë informacionin për metodat e llogaritjes së tarifave dhe kriteret e përdorura për të gjeneruar ato.
- **Konsultimi me Përdoruesit:** Kryen e konsultimeve të rregullta me përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH, për të adresuar çdo shqetësim ose nevojë të tyre dhe për të marrë feedback mbi politikat dhe rregulloret ekzistuese.
- **Mekanizmat e Ankesave dhe Korrigjimeve:** Përcakton mekanizma efikas për të trajtuar ankesat dhe kërkesat e përdoruesve nëse ata vërejnë diskriminim ose sjellje të pakëndshme në lidhje me shërbimet e ofruara nga OSSH/OSHEE Sh.A. Group.
- **Ndërtimi i Marrëdhënieve të Mirëfillta me Konsumatorët dhe Prodhuesit:** Përfundimi i marrëdhënieve me konsumatorët dhe prodhuesit e energjisë për të kuptuar më mirë nevojat e tyre dhe për të siguruar që shërbimet e ofruara nga OSSH për përdorimin e rrjetit elektrik të saj, janë në përputhje me kërkesat e tyre.
- **Mbikëqyrja e Përdorimit të Rrjetit:** Monitorimi i vazhdueshëm i përdorimit të rrjetit elektrik të OSSH nga përdoruesit energjise elektrike për të identifikuar shenjat e mundshme të diskriminimit dhe për të ndërhyrë nëse është e nevojshme për të korrigjuar sjelljet e padrejta.

Gjithashtu, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) në tregun e energjisë elektrike operon për të siguruar një qasje jo-diskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit të tij. Disa mënyra se si OSSH mund të sigurojë këtë qasje janë:

- **Rregullime të qarta dhe të përshtatshme:** OSSH ka rregulla dhe procedura të qarta dhe të drejtpërdrejta për; lidhjet e reja, përfitimet e rrjetit, çdo shërbim tjetër që ofrohet për përdoruesit e tij. Këto rregulla janë transparente dhe të njohura për të gjithë përdoruesit potencialë dhe të ekzistues të rrjetit.

- Përfaqësimi i përdoruesve: OSSH ka mekanizma për të dëgjuar dhe përfaqësuar interesat e të gjithë përdoruesve të rrjetit të tij, duke përfshirë konsumatorët, prodhuesit e energjisë së rinovueshme, operatorët e tregut, dhe të tjerë.
- Pavarësia dhe transparenca: OSSH operon në mënyrë të pavarur nga interesat e tij komerciale dhe është transparent në veprimet dhe vendimet e tij. Kjo përfshin publikimin e informacionit mbi performancën e rrjetit, rregulloret, dhe tarifat në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë.
- Procese të barabarta për lidhjet dhe shërbimet: OSSH zbaton procese të barabarta dhe të drejta për lidhjet e reja dhe për shërbimet e tjera të rrjetit për të siguruar që të gjithë përdoruesit të trajtohen me drejtësi dhe pa diskriminim.
- Monitorimi dhe mbikqyrja: OSSH ka mekanizma për të monitoruar dhe mbikqyrur veprimtarinë e tij për të siguruar përmbushjen e kërkesave për qasje jo-diskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Përmes këtyre veprimeve dhe përkushtimit të OSSH së për t'u përputhur me kërkesat dhe parimet e qasjes jo-diskriminuese, sigurohet që rrjeti i energjisë elektrike ofrohet në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit.

8. KONKURRENCA DHE MARRËDHENIET KOMERCIALE

OSSH Sh.A. angazhohet të respektojë dhe të sigurojë një treg të energjisë elektrike të drejtë dhe konkurrues, në përputhje me parimet dhe kërkesat e rregulloreve përkatëse. Aktivitetet e OSSH Sh.A. nuk duhet të kufizojnë, pengojnë ose ndikojnë negativisht në konkurrencën e drejtë në tregun e energjisë, duke siguruar një qasje të barabartë dhe jo-diskriminuese për të gjithë aktorët e tregut.

Për të përmbushur këtë kërkesë, OSSH Sh.A. ka ndërmarrë disa masa për të garantuar:

- Kërkesat teknike për kyçje: OSSH Sh.A. siguron që kërkesat teknike për kyçje të jenë të njëjta për të gjithë përdoruesit dhe të përmbushin standardet e nevojshme, pa diskriminim për asnjë palë.
- Procedurat dhe afatet e kërkesave për kyçje: Procedurat për kyçje janë të standardizuara dhe janë të qarta për të gjithë përdoruesit. Afatet kohore janë të përcaktuara dhe të respektuara, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në procesin e kyçjes.
- Standardizimi i kushteve kontraktuale dhe komerciale: OSSH Sh.A. ka implementuar kushte kontraktuale dhe komerciale të njëjta për të gjithë klientët, duke siguruar që ato janë të përputhshme me praktikën më të mirë dhe të drejtat e konsumatorëve, pa ndikuar në konkurrencë.
- Kostot e kyçjes: OSSH Sh.A. ka përcaktuar një strukturë të qartë dhe të drejtë tarifash për kyçjet, duke siguruar që kostot e kyçjes janë transparente dhe të arsyeshme për të gjitha palët, pa krijuar barriera të padrejta për aksesin në rrjet.

- Cilësia e shërbimit në lidhje me mirëmbajtjen dhe rregullimin e problemeve në rrjet: OSSH Sh.A. angazhohet të ofrojë një cilësi të lartë shërbimi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e problemeve në rrjet, duke siguruar që të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet janë të barabarta dhe të shpejta për të gjithë klientët, pa dallime të paarsyeshme
- Marrëdhëniet me kompanitë motra dhe partnerët: OSSH mund të ketë marrëdhënie komerciale edhe me kompani të tjera të lidhura, siç mund të jenë kompanitë motra të OSSH, si dhe me operatorë të tjerë të energjisë, për të siguruar ofrimin e energjisë elektrike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.
- Marrëdhëniet me përdoruesit e rrjetit: OSSH është në marrëdhënie komerciale me klientët e tij, duke ofruar shërbime të ndryshme të rrjetit, duke përfshirë lidhjet e reja, shërbimet e mirëmbajtjes, dhe të tjera. Këto marrëdhënie rregullohen nga rregulloret të ndryshme vendore dhe mund të përfshijnë tarifa të ndryshme dhe kushte kontratash.
- Marrëdhëniet me operatorët e tregut: OSSH ka marrëdhënie me operatorët e tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë operatorët e tregut të energjisë dhe furnizuesit e energjisë. Këto marrëdhënie mund të përfshijnë bashkëpunim për menaxhimin e ngarkesave, shkëmbimin e informacionit për planifikimin e kapacitetit, dhe të tjera.

Rregullat dhe kriteret për të parandaluar kufizimet ose ndikimin në konkurrencën e drejtë në tregun e energjisë elektrike për të siguruar një qasje jo-diskriminuese në marrëdhëniet komerciale përfshijnë:

- Transparenca e informacionit: OSSH siguron informacion në lidhje me proceset e shpërndarjes së energjisë dhe kërkesat teknike të jenë të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë operatorët:
 - Publikimi i informacionit;
 - Raportimi i performancës;
 - Aksesueshmëria e dokumentacionit dhe të dhënave;
 - Konsultimi me operatorët e tjerë;
 - Auditime dhe monitorim i pavarur.
- Procedurat e hapura dhe të përcaktuara për qasje në rrjet: OSSH ka procedura të përcaktuara dhe të njohura për operatorët që kërkojnë qasje në rrjet, pa diskriminim në favor të ndonjë operatori;
 - Koha dhe procesi i aplikimit;
 - Aplikimi i kriterëve në mënyrë të barabartë;
 - Monitorimi i pavarur.
- Rregullimi i çmimit dhe i tarifave: OSSH siguron mekanizma për monitorimin e çmimeve dhe tarifave të aplikuar nga OSSH për të siguruar që ato janë të drejta dhe të drejtpërdrejta për të gjithë operatorët.
- Monitorimi dhe raportimi i ndarjes së monopolit dhe aktiviteteve të tjera të OSSH: ERE monitoron veprimtarinë e OSSH dhe raporton për ndonjë shkelje potenciale të rregullave të konkurrencës ose të drejtat e operatorëve të tjerë sic janë:
 - Raportime financiare;
 - Auditime dhe verifikime periodike;

- Trasparencë e proceseve vendimarrëse;
- Monitorim i pavarur.
- Ndarja e funksioneve: Për të parandaluar konfliktet e interesit, për të siguruar konkurrencën e drejtë në treg, operatori i rrjetit elektrik realizon
 - Ndarjen e Qartë të Përgjegjësisë;
 - Transparenca dhe llogaridhënia.

9. ZBATIMI I PARIMEVE TË OBJEKTIVITETIT, TRANSPARENCËS DHE PAANSHMËRISË

OSSH sh.a. ka implementuar dhe vazhdon të zbatojë një qasje të fortë dhe të strukturuar për të siguruar objektivitetin, transparencën dhe paanshmërinë në të gjitha aktivitetet e saj, duke siguruar që të gjithë punonjësit dhe proceset operationale të jenë në përputhje me standardet ligjore dhe etike. Ky angazhim i vazhdueshëm është i domosdoshëm për të siguruar shërbime të drejtë dhe të besueshme për konsumatorët dhe për të mbajtur një nivel të lartë të besimit dhe besueshmërisë. Disa nga praktikatat dhe veprimet konkrete që OSSH ka ndërmarrë për të zbatuar:

9.1 Objektiviteti

Objektiviteti është një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së OSSH, pasi ky operator vepron në përputhje me rregullat dhe standardet që nuk favorizojnë asnjë palë të caktuar. Zbatimi i objektivitetit nga OSSH përfshin:

- Vlerësimi i kërkesave dhe procedurave pa ndikime të jashtme: OSSH vlerëson kërkesat për kyçje dhe shërbimet e tjera në mënyrë të paanshme, duke mos favorizuar asnjë kërkuar të veçantë për shkak të faktorëve jashtë procedurës.
- Përcaktimi i kushteve të barabarta për të gjithë palët: OSSH nuk krijon kushte të veçanta për asnjë konsumator apo operator, dhe të gjitha procedurat janë të përcaktuara në mënyrë të tillë që të ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë.
- Vendimet e bazuara në kritere objektive: Për çdo vendim që lidhet me çështje si tarifat, kërkesat për kyçje, dhe shpërndarja e energjisë, OSSH siguron që kriteret që përdoren janë të qarta, të arsyeshme dhe objektive, duke eliminuar çdo mundësi për ndikime të jashtme ose personale.

9.2 Transparenca

Transparenca është thelbësore për ndërtimin e besimit në sistemin e shpërndarjes dhe për të siguruar që të gjitha palët e interesuara kanë informacion të qartë dhe të saktë. Zbatimi i transparencës nga OSSH përfshin:

- Publikimi i informacionit për procedurat dhe politikat: OSSH publikon informacion të detajuar dhe të kuptueshëm për politikat e tij, përfshirë proceset për kyçjen në rrjet, tarifat e aplikueshme, dhe çdo ndryshim të mundshëm në këto kushte. Kjo lejon konsumatorët dhe operatorët të kenë një pasqyrë të qartë mbi rregullat dhe kushtet e tregut.

- Raportimi i performancës dhe aktiviteteve: OSSH është përgjegjës për raportimin e performancës së tij dhe për transparencën në lidhje me shërbimet që ofron dhe raporton në ERE për performacën të ndryshme në përputhje me aktet Ligjore në fuqi. Kjo mund të përfshijë raporte për cilësinë e shërbimit, kohën e reagimit ndaj problemeve në rrjet, si dhe të dhëna mbi kostot e shërbimeve dhe tarifat që aplikohen.
- Mbikëqyrja dhe auditimi i jashtëm: OSSH ka detyrimin të mbështesë mbikëqyrjen nga autoritetet rregullatore dhe të sigurojë auditime të jashtme të aktiviteteve të tij, për të garantuar që ai po vepron në përputhje me ligjin dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente.

9.3 Paanshmëria

Paanshmëria ka të bëjë me sigurinë që OSSH nuk favorizon asnjë palë, individ apo grup interesash gjatë aktiviteteve të tij. Zbatimi i paanshmërisë nga OSSH përfshin:

- Veprimi pa preferenca për asnjë aktor të tregut: OSSH siguron që të gjitha vendimet e tij – qoftë për tarifat, për proceset e kyçjes, apo për shërbimet që ofron – të jenë të ndara nga çdo ndikim të jashtëm dhe të bëhen në përputhje me rregullat e përcaktuara pa ndikuar favorizueshëm për asnjë palë.
- Ndihma e barabartë për të gjithë përdoruesit e rrjetit: Kur ndodhin probleme në rrjet, si ndërprerje të furnizimit me energji, OSSH siguron që shërbimi të ofrohet në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit, duke marrë parasysh urgjencën dhe rëndësinë e shërbimeve pa favorizuar ndonjë konsumator apo operator të veçantë.
- Përdorimi i kriterëve të paanshme për ndihmën dhe mbështetje për operatorët: Kur ofrohen shërbime si ndihma për ndërtimin e infrastrukturës apo kyçja në rrjet, OSSH siguron që këto shërbime të ofrohen në përputhje me rregullat dhe në mënyrë të paanshme për të gjithë palët që kërkojnë shërbime.

9.4 Roli i Autoritetit Rregullator të Energjisë (ERE)

Për të siguruar që parimet e objektivitetit, transparencës dhe paanshmërisë zbatohen, OSSH është nën mbikëqyrjen e Autoritetit Rregullator të Energjisë (ERE). Ky organ rregullator miraton tarifat dhe rregullat për OSSH dhe siguron që ai të veprojë në përputhje me ligjin dhe rregulloret e vendit.

9.5 Mekanizmat e Monitorimit dhe Auditimit

OSSH është gjithashtu i detyruar të ofrojë mundësi për mbikëqyrje të jashtme dhe auditime për të siguruar që praktikatat dhe procedurat e tij janë të drejta dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare. Kjo përfshin:

- Auditimi i jashtëm i procesit të kyçjes në rrjet dhe shërbimeve të tjera.
- Kontrolli i përdorimit të fondeve dhe të çmimeve të ofruara për shërbimet.
- Përgjegjësia për zbatimin e ndryshimeve që sugjerohen nga autoritetet rregullatore.

Zbatimi i parimeve të objektivitetit, transparencës dhe paanshmërisë nga OSSH është thelbësor për krijimin dhe ruajtjen e një tregu të energjisë konkurrues dhe të drejtë. Ky operator ka përgjegjësinë që të ofrojë shërbime të barabarta dhe të drejta për të gjithë aktorët në treg, ndërsa autoritetet rregullatore dhe mekanizmat e mbikëqyrjes sigurojnë se këto parime zbatohen në praktikë.

10. E DREJTA E INFORMIMIT

OSSH dhe OSHEE, në bashkëpunim të ngushtë, kanë realizuar një punë të rëndësishme për të siguruar mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe për të garantuar respektimin e plotë të kërkesave ligjore dhe rregullative. Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit është plotësisht në përputhje me ligjin dhe ka zbatuar mekanizma dhe rregulla të forta për mbrojtjen e këtyre informacioneve, sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe direktivat përkatëse.

Departamenti siguron që informacionet mbrohen dhe ruhen siç kërkohet nga ligji dhe praktikat më të mira të sigurisë. Të gjitha procedurat dhe politikat e mbrojtjes së informacionit janë të miratuara dhe zbatuara në përputhje me rregullat dhe kërkesat ligjore, duke garantuar që OSSH të jetë plotësisht e përputhshme me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

. Pikat kryesore janë si më poshtë:

- Mekanizmat e brendshëm dhe rregullat për mbrojtjen e informacioneve të ndjeshme, si dhe mënyra se si sigurohet që kompanitë motra të OSSH-së nuk gëzojnë përparësi diskriminuese në aksesin e informacionit të ndjeshëm.
- Politikat për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm, duke përfshirë procedurat dhe masat për të siguruar që informacioni komercial dhe operativ mbrohet nga akseset e paautorizuara dhe i ruhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative

Objektivat dhe angazhimet e Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit për vitin 2024 janë thelbësore për avancimin dhe zhvillimin e sigurisë, performancës dhe efikasitetit të infrastrukturës IT në OSSH/OSHEE. Këtu janë objektivat kryesore:

- Business continuity & disaster recovery – Sigurimi i vazhdimësisë së biznesit dhe zhvillimi i planeve për rikuperimin nga katastrofat.
- Cyber recovery & system vault – Zhvillimi i masave për rikuperimin e të dhënave dhe siguria e sistemeve të ruajtjes së informacionit.
- Virtualizimi i platformave të sistemeve kritike – Përdorimi i teknologjive të virtualizimit për të optimizuar platformat dhe përmirësuar performancën.
- Mirëmbajtja dhe upgrade i infrastrukturës – Sigurimi i vazhdimësisë së operacioneve dhe përmirësimi i infrastrukturës teknologjike.
- Ndërtimi i rrjetit kompjuterik dhe kalimi në teknologjinë DMVPN – Modernizimi i rrjetit kompjuterik dhe kalimi në teknologji të avancuara për siguri dhe performancë të lartë.
- Segmentimi i mëtejshëm i rrjetit kompjuterik – Zbatimi i masave të segmentimit për të rritur sigurinë dhe menaxhimin e rrjetit.

- Implementimi i Cisco AAA për përdorues në HQ – Përdorimi i autentifikimit dhe autorizimit të avancuar për menaxhimin e përdoruesve.
- Implementimi i zgjidhjes ZTNA për përdorues në HQ – Zbatimi i një platforme të sigurt për lidhjet e përdoruesve të largët.
- Monitorimi i infrastrukturës së rrjetit – Mbikëqyrja e vazhdueshme e performancës dhe sigurisë së rrjetit.
- Implementimi i Cisco Umbrella URL Filtering – Zbatimi i filtrimit të URL-ve për të mbrojtur rrjetin nga kërcënimet e internetit.
- Implementimi i zgjidhjes DNS Proxy On-Prem – Përdorimi i një proxy DNS për rritjen e sigurisë dhe menaxhimit të trafikut në rrjet.
- Mbrojtja e faqeve web nga sulmet DDoS – Sigurimi i mbrojtjes së faqeve web kundër sulmeve të shpërndarjes së shërbimeve (DDoS).
- Krijimi i OSHEE online/mobile – Zhvillimi i platformave online dhe mobile për përmirësimin e shërbimeve për klientët.
- Krijimi i platformës për menaxhimin e shoqërive prodhuese – Zhvillimi i një platforme për menaxhimin dhe koordinimin e shoqërive prodhuese të OSSH.

Qëllimi kryesor i të drejtës së informimit është të mundësojë transparencën dhe të sigurojë se përdoruesit e rrjetit dhe palët e tjera të interesuara kanë mundësinë të kenë akses në informacionin e rëndësishëm për shërbimet që ofrohen, praktikën dhe politikat e OSSH, si dhe për çdo ndryshim që mund të ndikojë në cilësinë dhe kushtet e shërbimit. Në këtë mënyrë, përdoruesit janë të informuar për drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe për mundësitë që ata kanë për të ndjekur procedura për trajtimin e ankesave, kërkesave dhe shqetësimeve. Disa prej tyre janë:

- Faqja Zyrtare e Internetit (www.ossh.al): Ka një faqe zyrtare në internet dhe website që është një mjet i rëndësishëm për publikimin e informacionit të rëndësishëm ku OSSH mund të publikojë raporte vjetore, informacione për tarifat, politikat dhe procedurat e shërbimeve, dhe të dhëna për performancën e rrjetit elektrik të saj.
- Raportet Vjetore: OSSH-ja harton dhe publikon raporte vjetore të performancës së saj, të cilat përfshijnë informacionin për sigurinë e rrjetit, shërbimet e ofruara, investimet, dhe zhvillimet e tjera të rëndësishme.
- Informacioni i publikuar në mënyrë të vazhdueshme: OSSH është e angazhuar për të siguruar që informacionet përkatëse, siç janë politikat, tarifat e shërbimeve, procedurat e ankesave, dhe çdo dokument tjetër i rëndësishëm për përdoruesit e rrjetit, janë të disponueshme për publikun. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të internetit të OSSH dhe përmes kanaleve të tjera të komunikimi.
- Konsultime Publike: Organizimi i konsultimeve publike dhe sesioneve informuese për të diskutuar politikat e reja, tarifat dhe çdo ndryshim tjetër që ka ndikim në përdoruesit e rrjetit elektrik.

- Njoftimet dhe Komunikimi Direkt: OSSH-ja bën njoftime dhe komunikime direkte me përdoruesit e rrjetit elektrik përmes e-mail-it, letrave informative, ose mesazheve në faqen e saj në internet.
- Raportimi në Media dhe Lajmet: Informacioni i rëndësishëm për performancën, tarifat dhe politikat e OSSH-së raporton në media lokale dhe në lajmet e rrjeteve sociale për të arritur një audiencë më të gjerë.
- Qendra e Shërbimeve dhe Ndihma për Përdoruesit: OSSH siguron i një qendër të shërbimeve dhe ndihmë për konsumatorët dhe prodhuesit për t'ju përgjigjur pyetjeve dhe për të ofruar ndihmë në lidhje me informacionin dhe politikat e OSSH-së.

E drejta e informimit është një parim i domosdoshëm për sigurimin e besimit dhe transparencës në menaxhimin e shërbimeve të shpërndarjes së energjisë. OSSH angazhohet të respektojë këtë të drejtë dhe të sigurojë që çdo përdorues i rrjetit të ketë mundësinë të marrë informacion të saktë, të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për shërbimet që ofrohen. Përmes zbatimit të kësaj politike, OSSH siguron një komunikim të qartë dhe të hapur me të gjithë përdoruesit, duke i mundësuar atyre të kenë një përvojë të drejtë dhe të informuar.

10.1 Risitë e Shërbimeve Online të OSHEE/OSSH për Konsumatorët në Përputhje me Standardet Bashkëkohore;

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët dhe duke e përmirësuar më tej efikasitetin e ofrimit të shërbimeve, OSHEE dhe OSSH kanë lançuar një portal të ri dhe të aksesueshëm për të gjithë klientët, që mundëson marrjen e shërbimeve online në formën më të shpejtë dhe më praktike të mundshme. Ky portal është një hap i rëndësishëm për të ofruar shërbime të përmirësuara dhe për të optimizuar kohën dhe përvojën e klientëve, duke eliminuar nevojën për vizita fizike në sportelet e Kujdesit ndaj Klientit.

Shërbimet Online dhe Përfitimet për Konsumatorët:

1. Portal i Ri dhe Akses Online për Shërbime:

- Të gjitha shërbimet janë të aksesueshme nëpërmjet portalit të ri www.oshee.al dhe www.oss.al, si dhe përmes aplikacionit celular OSHEE Mobile. Ky është një hap përpara në përafrimin e OSSH/OSHEE me standardet bashkëkohore të shërbimit ndaj klientit.

2. Zgjerimi i Gamës së Shërbimeve Online:

- Nuk është më e nevojshme të humbni kohë në sportelet e Kujdesit ndaj Klientit. Të gjitha shërbimet kryesore janë tani të disponueshme online, duke përfshirë:
 - Menaxhimi i kontratave (gjenerimi automatik i vertetimit të debisë, pagesa online e faturave, shikimi i historikut të konsumit dhe pagesave).
 - Kërkesa dhe ankesa online (faturim, ndryshime të të dhënave të kontratës, cilësia e shërbimit, ankesa për defekte dhe matesin, etj.).
 - Informacion i detajuar mbi kontratën dhe historikun e kërkesave/ankesave.

3. Lidhja e Re dhe Shërbimi i Lidhjes së Kontratës Online:

- Shërbimi i lidhjes së kontratës me OSHEE dhe OSSH do të ofrohet online, një shërbim që ka qenë njëri ndër më të kontestuarit nga konsumatorët për shkak të praktikave të kaluara që shkaktonin zvarritje dhe humbje kohe. Ky proces tani mund të ndjeket plotësisht online, pa asnjë vonesë, duke sjellë një përvojë më të shpejtë dhe më efikase për konsumatorin.

4. Ndjekja e Procesit Online:

- Abonentët mund të ndjekin hap pas hapi të gjithë procesin e aplikimit për shërbimin e kërkuar dhe të shohin në cilën fazë ndodhet kërkesa e tyre, duke përdorur kodin unik për të gjurmuar çështjen në platformën online. Ky sistem është krijuar për të siguruar një përvojë të thjeshtë dhe të përshtatshme për klientët.

5. Shërbimet Mobile:

- Përmes aplikacionit të OSHEE Mobile, konsumatorët mund të shkarkojnë faturat, si dhe të marrin shërbime të ndryshme direkt nga celulari i tyre, duke eliminuar nevojën për ndërhyrje fizike dhe duke mundësuar akses në çdo kohë dhe nga çdo vend.

Përfitimet e Shërbimeve Online për Konsumatorët:

- Përmirësimi i Efikasitetit dhe Shpejtësisë: Proceset dhe shërbimet janë bërë më të shpejta dhe më efikase, duke eliminuar vonesat dhe komplikimet e mëparshme.
- Praktikiteti: Konsumatorët mund të aksesojnë dhe menaxhojnë shërbimet e tyre në çdo kohë dhe nga çdo vend, përmes platformave online dhe aplikacionit celular.
- Përvojë më e mirë për klientin: Proceset janë të thjeshtuara dhe janë bërë më transparente, duke mundësuar ndjekjen e çdo faze të kërkesës për shërbim.
- Kosto më e ulët për klientët: Eliminohet nevoja për vizita fizike, kursimi i kohës dhe mundësitë për kursime të mundshme të tjera.

OSSH dhe OSHEE, në bashkëpunim të ngushtë, kanë angazhuar të ofrojnë një eksperiencë të përmirësuar dhe moderne për të gjithë konsumatorët, duke integruar shërbimet online për të mundësuar akses të shpejtë dhe të lehtë në çdo moment dhe nga çdo vend. Kjo iniciativë është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së standardeve bashkëkohore dhe ofrimit të shërbimeve të cilësisë më të lartë, duke përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe përvojën e përdoruesve.

11. POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E SIGURISË KIBERNETIKE

Politikat dhe Praktikrat e Sigurisë Kibernetike të Shoqërisë për Vitin 2024 janë hartuar dhe zbatuar në përputhje me:

- Ligjin Nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike", në veçanti nenet 16, 17 dhe 21;

- Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 30.07.2020, në përputhje me nenet 5, 6, 6/1 dhe 10;
- Rregulloren mbi Mënyrën e Dokumentimit dhe Implementimit të Masave të Sigurisë në Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, miratuar me Urdhër Nr. 97, datë 05.03.2024, versioni 3.0;
- Rregulloren e Përgjithshme të Shoqërisë OSHEE GROUP SHA, miratuar me Nr. 3000/1 prot., datë 11.04.2024.

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) i zhvilluar nga OSHEE GROUP SHA është ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të ISO 27001 dhe NIST, dhe është miratuar më datën 16.07.2024, me Nr. 6015/1 prot. Ky sistem përmban rregullore, procedura dhe kontrolle për të siguruar:

- Konfidencialitetin e informacionit, duke garantuar aksesin e kufizuar për personat dhe pajisjet e autorizuar;
- Integritetin e të dhënave, duke siguruar që ato janë të sakta dhe të paprekura nga modifikime të paautorizuara;
- Disponueshmërinë e informacionit, duke siguruar akses të pandërprerë në sistemet dhe informacionet e nevojshme.

Verifikimi dhe Implementimi i Kontrollove: Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është një mjet për menaxhimin e rrezikut dhe siguron qëndrueshmërinë kibernetike dhe operacionale të OSHEE/OSSH.

Kontrolloret janë të organizuar në grupe dhe secili seksion përqendrohet në një aspekt të caktuar të sigurisë së informacionit.

Aksesimi i Sistemit: Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është i disponueshëm për të gjithë përdoruesit që kanë akses në infrastrukturën TIK të OSHEE GROUP SHA, përmes intranetit të kompanisë.

12. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Në përputhje me Marrëveshjen për Ofrimin e Shërbimeve, nr. 13531 datë 29.12.2023 dhe nr. 9891 datë 26.12.2023, me afat 2 vjeçar, Shoqëria “OSHEE GROUP” SH.A. ka ofruar shërbime të përbashkëta brenda grupit, të cilat janë në fuqi nga data 1 Janar 2024. OSHEE ka nënshkruar kontratën e shërbimit me OSSH dhe është fokusuar në ofrimin e shërbimeve të specializuara për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shpenzimeve, duke përdorur burimet njerëzore dhe informacionet historike që OSHEE ka trashëguar si shoqëri mëmë.

Kostoja e shërbimeve korporative llogaritet në bazë të planit financiar të shoqërisë për secilin shërbim, dhe faturimi bëhet çdo muaj. Vlerësimi përfundimtar i çmimit të shërbimeve bëhet brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, dhe çdo ndryshim faturizohet. Shërbimet e ofruara synojnë krijimin e rezervave ligjore dhe investime për rritjen e efikasitetit, pa synuar krijimin e fitimit.

Llogaritja e shpërndarjes së kostove bazohet në parimet e transparencës, matshmërisë dhe saktësisë, dhe shërbimet ofrohen me kosto të ulëta, në përputhje me kërkesat e programit dhe përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 43/2015 për shërbimet që ofrohen nga OSSH. Ky raport përmbush kërkesat ligjore dhe detyrimet që dalin nga SLA dhe ligji në fuqi.

a. Shpenzimet për shërbime korporative

Përqëndrimi i shërbimeve të grupit në një shoqëri të veçantë brënda grupit ka si qëllim ofrimin e specializuar të këtyre shërbimeve duke rritur cilësinë dhe performancën e shpenzimeve nëpërmjet specializimit të ngushtë duke shfrytëzuar me efikasitet burimet njerëzore dhe informacionet historike që shoqëria OSHEE (si shoqëri mëmë) ka trashëguar.

Ky përqëndrim mundëson uljen e shpenzimeve për njësi të shërbimeve të cilat do të ishin shumë më të mëdha nëse do të organizoheshin drejtpërdrejt nga shoqëritë e ndara (bija).

Në përputhje me objektin e ri të liçensuar të aktivitetit OSHEE ka nënshkruar kontratën e shërbimit me OSSH për shërbimet si më poshtë:

- Shërbime të Burimeve Njerëzore;
- Shërbime Ligjore;
- Shërbime të Informacionit dhe Inovacionit
- Shërbime Mbështetëse;
- Shërbime IT;
- Shërbimet Ekonomike;
- Shërbime të Përmirësimit të Performacës;
- Shërbime të projekteve me financim të huaj;
- Shërbime të Sigurisë Kibernetike.

Kosto e shërbimeve korporative, bazuar në kontratat e lidhura, për vitin në vazhdim llogaritet bazuar në planin financiar të shoqërisë për çdo shërbim dhe faturohet për çdo muaj bazuar mbi këtë përlllogaritje, ndërsa vlerësimi përfundimtar vjetor i çmimit të shërbimit bëhet brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës dhe faturohet diferenca.

Kryerja e shërbimeve të përqëndruara nuk ka si qëllim krijimin e fitimit të shoqërisë por ka si qëllim krijimin e rezervave ligjore dhe të domosdoshme, si dhe investime në rritje të efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

b. Metoda e llogaritjes së kostos së shërbimeve korporative

Metoda e llogaritjes së shërbimeve korporative kalon në 2 faza kryesore:

a) Llogaritja e kostos totale të shërbimit

Struktura organizative e OSHEE është ndërtuar duke u bazuar në shërbimet e ofruara dhe përbëhet nga:

- Administrimi i Përgjithshëm (Këshilli Mbikqyrës, Auditim, Njësi zbatim projektsh)
- Departamenti Informacionit dhe Inovacionit;
- Departamenti i Përmiresimit të Performacës;
- Departamenti e Burimeve Njerëzore;
- Departamenti Ligjore;
- Departamenti Shërbimeve Mbështetëse;
- Departamenti Teknologjisë së Informacionit;
- Departamenti Ekonomik;
- Departamenti Sigurise Kibernetike.

Kostot e shërbimeve koorporative në shoqërinë OSHEE evidentohen sipas qendrave të kostos bazuar në përbërjen e strukturës organizative të shoqërisë mbi të cilat është ndërtuar edhe evidentimi i kostove në programin financiar SAP.

Pasi merren të dhënat vjetore të evidentuara të kostove sipas secilës nga qendrat e kostos në sistemin SAP bëhet shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme të shoqërisë e cila përfshihet në qendrën e parë të kostos sipas listimit më sipër bazuar në peshën specifike të kostove vjetore të njësive të tjera ndaj totalit të kostos. Bazuar në kontratën e shërbimit llogaritet edhe kosto e kapitalit të shoqërisë dhe shpërndahet me të njëjtën metodë të peshës specifike të llogaritur.

b) Shpërndarja e kostos së shërbimit për shoqëritë e grupit

Shpërndarja e kostove të shërbimeve të OSHEE sh.a. për shoqëritë bija bazohet në raportet e shpërndarjes të cilët janë specifike për secilin lloj shërbimi. Llogaritja e shpërndarjes së kostove bazohen në parimet e mëposhtme:

- Duhet të jenë transparente dhe lehtësisht të kuptueshëm;
- Duhet të jenë të matshëm;
- Duhet të pasqyrojnë në masën më të madhe të mundshme një përfaqësim të saktë të përkatësisë së kostove.

13. ALOKIMI KOSTOS NË OSSH

Në Operator Sistemi Shpërndarjes (OSSH), kostot alokohen në mënyra të ndryshme në përputhje me praktikat e ndryshme të industrisë dhe rregulloret vendore.

Disa mënyra të zakonshme për alokimin e kostove në OSSH janë:

- Metodologjia e alokimit të kostos për shërbimet e ofruara: Kostot operative përfshijnë shpenzimet e përditshme për operacionin e rrjetit të shpërndarjes, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje, menaxhimin e energjisë, zbatimin e rregullores, pagesat e punëtorëve, dhe të tjera. Këto koste janë të shpërndara në të gjithë rrjetin në mënyrë proporcionale me përdorimin e rrjetit.

- **Kostot e investimeve:** Kostot e investimeve përfshijnë shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës së re dhe për modernizimin e rrjetit. Këto koste mund të alokohen në baza të ndryshme, siç janë numri i klientëve, përdorimi i rrjetit, ose sipas rregulloreve vendore.
- **Kostot e financimit:** Kostot e financimit përfshijnë shpenzimet për interesat e borxhit dhe të financimit të kapitalit të nevojshëm për operacionet dhe investimet e rrjetit. Këto koste janë të shpërndara në të gjithë rrjetin bazuar në strukturën e financimit të OSSH-së.
- **Kostot e zbatimit të rregullores:** Kostot e zbatimit të rregullores përfshijnë shpenzimet për përputhjen me rregullat dhe standardet e vendosura nga organet e rregullimit. Këto koste janë të përfshira në tarifat që paguajnë përdoruesit e rrjetit.
- **Kostot e humbjeve të energjisë:** Kostot e humbjeve të energjisë përfshijnë shpenzimet për humbjet fizike të energjisë gjatë transmetimit dhe shpërndarjes së saj në rrjet. Këto koste janë të shpërndara në bazë të formës së humbjes dhe të rregulloreve vendore.
- **OSSH përdor një kombinim të këtyre metodave për të siguruar një alokim të drejtë dhe efikas të kostove në rrjetin e tij, duke marrë parasysh nevojat e përdoruesve të rrjetit dhe rregulloreve të vendit.**
- **Është e rëndësishme që alokimet e kostove të janë transparente dhe të kontrollueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit dhe organet e rregullimit.**

14. ZBATIMI I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË

Si pjesë e implementimit të organigramës së re, është siguruar që të gjitha drejtoritë e reja, janë informuar plotësisht mbi Programin e Pajtueshmërisë dhe obligimet që rrjedhin prej tij. Ky proces ka përfshirë:

- **Përhapja e informacionit të detajuar:** Programi i Pajtueshmërisë është shpërndarë në mënyrë të detajuar për çdo drejtor dhe punonjës sipas nivelit perkates nga Zyrtari Pajtueshmërisë. Ky informacion përfshin aspekte të rëndësishme të programit, duke përfshirë kërkesat ligjore dhe detyrimet që ka secili individ brenda organizatës, si dhe praktikën më të mirë për të siguruar përputhshmërinë.
- **Shpjegimi i kërkesave ligjore dhe rregullatorëve:** Drejtorët dhe punonjës e tyre janë informuar mbi ligjet dhe rregullat që kanë ndikim në operacionet e përditshme të OSSH dhe OSHEE. Kjo ka përfshirë ligjet që lidhen me etikën, konkurrencën, transparencën dhe përgjegjësinë për mospërputhshmëritë.
- **Çdo drejtor i ri është bërë i njohur me përgjegjësinë e tij për implementimin dhe monitorimin e Programit të Pajtueshmërisë në departamentin përkatës.** Ky informacion është siguruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke i mundësuar çdo drejtuesi të ketë një kuptim të plotë të aspekteve të Programit dhe të veprojë në përputhje me to.

Gjatë vitit 2024, OSSH dhe OSHEE Group kanë bërë hapa të mëdhenj në forcimin e përputhshmërisë me legjislacionin kombëtar, duke u fokusuar në implementimin e standardeve më të larta. Ky bashkëpunim ka qenë kyç në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në operacionet e përditshme të kompanisë, duke siguruar që çdo aktivitet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Disa nga arritjet më të rëndësishme të periudhës përfshijnë:

- Përmirësimi i Praktikave të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes: OSSH dhe OSSHEE Group kanë ndërmarrë masa përforcuese në monitorimin e proceseve të brendshme dhe të ndërveprimeve komerciale, duke siguruar që çdo aktivitet të zbatohet në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorëve.
- Implementimi i Masave për Shmangien e Diskriminimit dhe Nxitja e Diversitetit: Është bërë një angazhim i fortë për të siguruar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë palët e interesuara, duke zbatuar politika për parandalimin e çdo forme diskriminimi dhe promovimin e diversitetit dhe barazisë në të gjitha nivelet e operacioneve.
- Përditësimi dhe Azhurnimi i Procedurave të Brendshme: OSSH dhe OSSHEE Group kanë rishikuar dhe përditësuar procedurat e brendshme për t'iu përshtatur ndryshimeve të legjislacionit dhe kërkesave të industrisë, duke u fokusuar në rritjen e efikasitetit operativ dhe sigurinë e informacionit.

Zbatimi i Programit të Pajtushmërisë është një proces i rëndësishëm për të siguruar që OSSH të operojë në përputhje me ligjin dhe me parimet e etikës dhe transparencës. Ky program duhet të jetë një mjet i fortë për shmangien e çdo praktike diskriminuese dhe për të garantuar që shërbimet e ofruara për konsumatorët janë të drejta, të barabarta dhe të besueshme.

Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH. Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OSSH, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, si dhe palët e tjera të treta.

Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit, kanë konfirmuar me shkrim dhe e-mail që janë të informuar dhe do ta zbatojnë Programin. Për çdo shkelje të dispozitave të Programit, drejtuesit ose punonjësit e OSSH informojnë menjëherë Zyrtarin e Pajtushmërisë. Në rast të konstatimit, shkelja e ndonjë dispozite të Programit i jap OSSH të drejtën për të aplikuar procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë aspekt më duhet të theksoj që unë si Zyrtar Pajtushmërie sapo kam marrë detyren kam informuar stafin OSSH për tu njohur me programin dhe që ky është një detyrim ligjor për ta zbatuar të gjithë. Gjithashtu në kuadër të njohjes së programit kam marrë konfirmim me shkrim nga punonjësit që janë njohur me programin.

Ndërkohë jam në proces të zhvillimit të trajnimeve në lidhje me programin dhe informacion adekuat dhe transparent për punonjësit e rrinj që janë bashkuar dhe do të bashkohen në vazhdimësi në OSSH.

Për të siguruar zbatimin e plotë të këtij Programi, Zyrtari i Pajtushmërisë është i obliguar për:

- Sigurimi i Transparencës dhe Etikës;
- Përditësimin e Programimit;

- Hulumtim i dokumentacionit të vënë në dispozicion (të tilla si vendime, kontrata, rregullore, relacione etj);
- Hartimin e Raportit Vjetor lidhur me zbatimin e Programit.
- Raportin mbi implementimin dhe monitorimin e Programit, përputhshmërinë e akteve dhe proceseve të brendshme të shoqërisë me Programin e Pajtueshmërisë

Zyrtari i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor të detajuar. Zyrtari i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij.

15. HUMBJET TOTALE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2024

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sha është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike, si mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike përfaqësojnë humbjet teknike në rrjet dhe humbjet joteknike.

Sikurse evidentohet me poshte, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2024 janë në nivelin 17.93%, kundrejt objektivit 18.5%, pra me një ulje prej -0.57% mbi targetin e vendosur në VKM nr. 758, datë 09.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”.

Humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2023, u mbyllën në masën 18.93%.

Viti 2024 rezulton me një ulje të nivelit të humbjeve prej -1.0 % krahasuar me vitin 2023

Viti 2024 krahasuar me vitin paraardhës 2023 rezultatet janë si më poshte:




Figura 1. Humbjet totale, teknike dhe joteknike (%)

15.1 Tarifat e shperndarjes se energjise elektrike

Tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në zbatim të vendimit të Bordit të EREs Nr. 365, Datë 15.12.2023, i cili ka lene ne fuqi vendimin Nr. 73, Datë 13.04.2022, deri ne aplikimin e OSSH Sh.a për ndryshimin e tarifave ekzistuese, vendosi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, të mbeten si vijon:

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35kV-1.55 Lekë/Kwh.

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV - 3.99 Lekë/Kwh.

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV-6.42 Lekë/Kwh.

Miratimin e çmimit të aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive prej 1.92 lekë/kVArh.

Për sa më sipër Shoqëria OSSH.Sha ka vepruar dhe zbatuar në përputhje të plote këto cmime sipas vendimit të ERE.

15.2 Treguesit e Bilancit Energjitik

Bazuar në ligjin "Për Sektorin e Energjisë" dhe Modelin e Tregut të Energjisë të miratuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka për detyrë të sigurojë energji me qellim të përmbush kërkësat e konsumatorëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit dhe nga Furnizuesit e tjerë të linçensuar.

Energjia elektrike në rrjetin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit ka injektuar për vitin 2024 në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6,881 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura direkt në rrjetin e shpërndarjes kanë injektuar në këtë rrjet sasinë e energjisë elektrike prej rreth 1,000 GWh.

Humbjet e përgjithshme në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2024 arrijnë në 17.93%, duke shënuar kështu ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2023.

Bilanci Energjitik per vitet 2019 – 2024

Pershkrimi		Progresive 2019	Progresive 2020	Progresive 2021	Progresive 2022	Progresive 2023	Progresive 2024
Energjia e injektuar nga OST ne rrjetin e OSSH	T	6,137,250	6,184,178	6,606,381	6,545,568	6,491,776	6,881,029
Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et ne rrjetin e OSSH	T.1	229,380	180,053	415,433	354,379	516,517	455,834
Energji e transmetuar per OSSH - Bilanc NET	T.2=T-T.1	5,907,870	6,004,125	6,190,949	6,191,189	5,975,259	6,425,195
Energji e transmetuar nga OSSH	T.3=T.2+P	6,576,432	6,605,083	7,136,936	7,046,021	7,061,769	7,425,179
Prodhim i injektuar ne OSSH nga BREE-t	P=a+b+c+d+e	668,561	600,958	945,988	854,831	1,086,510	999,984
Prodhim nga HEC-et e mesem - me kontrate me FTL	a	33,368	28,643	27,504	25,423	23,244	15,134
Prodhim nga HEC-et private dhe koncesionet- me kontrate me FTL	b	612,997	540,050	877,727	777,899	982,392	852,337
Energjia e injektuar nga Imp. Fotovoltaike dhe te tjere - me kontra	c	22,196	32,265	40,756	50,092	58,430	95,688
Prodhim i injektuar ne OSSH nga BREE-t ne Treg te Parregulluar	d	-	-	-	1,417	22,444	35,104
Prodhim i injektuar nga Veteprodhuesit ne Treg te Parregulluar	e	-	-	-	-	14,603	1,721
Energjia Totale ne rrjetin e OSSH	3 = T+P	6,805,811	6,785,136	7,552,369	7,400,399	7,578,286	7,881,013
Energji Totale e perdorur ne OSSH	4=S/1+12+13+14	5,322,850	5,327,396	5,995,416	5,941,143	6,144,012	6,468,095
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH	5 = 6+8	1,482,962	1,457,740	1,556,953	1,459,257	1,434,274	1,412,918
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH (%)	5 / 3	21.79%	21.48%	20.62%	19.72%	18.93%	17.93%
Humbjet teknike ne njesite TL	6 = 3 -(7+11)	117,739	103,729	107,340	94,747	98,166	101,039
Humbjet teknike ne njesite TL (%)	6 / 3	1.73%	1.53%	1.42%	1.28%	1.30%	1.28%
Energji per Zonat e OSSH	7	6,684,100	6,677,351	7,440,731	7,301,298	7,475,669	7,775,421
Humbjet ne zonat e OSSH	8=7-(S+T.1+12+13)	1,365,222	1,354,012	1,449,613	1,364,509	1,336,107	1,311,878
Humbje ne zonat e OSSH (%)	8 / 7	20.42%	20.28%	19.48%	18.69%	17.87%	16.87%
Humbjet Teknike	9	836,561	828,906	921,330	886,682	892,334	896,245
Humbjet Teknike (%)	9 / 3	12.52%	12.41%	12.38%	12.14%	11.94%	11.53%
Humbjet Jo Teknike	10= 8-9	528,661	525,106	528,283	477,828	443,774	415,634
Humbjet Jo Teknike (%)	10 / 3	7.77%	7.74%	6.99%	6.46%	5.86%	5.27%
Energji e shitur per klientet e FSHU Sh.a	S	5,048,288	5,044,888	5,464,100	5,506,588	5,567,539	5,522,648
Energji e shitur nga FSHU (konsumi vetjak te Njesive te TL te OSSH	11	3,972	4,056	4,298	4,354	4,451	4,553
Energji e Totale Shitur nga FSHU Sh.a	5/1=S+11	5,052,261	5,048,944	5,468,398	5,510,942	5,571,990	5,527,201
Energji per klientet e dal ne treg te parregulluar	12	41,209	67,126	82,829	50,607	44,306	478,801
Demi Ekonomik (aplikimi vendimit te ERE 232/2019)	13	-	31,272	28,756	25,215	11,200	6,259
Energji e injektuar ne OST nga Hec-et ne rrjetin e OSSH	14=T.1	229,380	180,053	415,433	354,379	516,517	455,834

Tab 2 Përshkrimi i bilancit total energjitik për rrjetin e shpërndarjes

Në tabelën e mëposhtme jepet një krahasim i nivelit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, me target vjetor të vendosur në VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021, "Për një ndryshim në vendimin nr.253, datë 24.04.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik".




Figura 2. Humbjet mujore/vjetore në sistemin e shpërndarjes, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike.

Humbjet totale ndër vite në rrjetin e shpërndarjes:




Figura 3. Humbjet (%) vjetore në rrjetin e shpërndarjes

Në figurën e mësipërme paraqitet ecuria e humbjeve totale (%) të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, gjatë periudhës 2013 – 2024. Të dhënat tregojnë se humbjet e energjisë elektrike në % kanë trend zbritës. Për vitin 2024, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes janë 1,413 GWh. Krahasuar me vitin 2023, vihet re një ulje e humbjeve totale të energjisë elektrike me 21.3 GWh. Në të

njëjtën kohë duhet evidentuar fakti se rritja e kërkeses për energji elektrike për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, shkon në rreth 303 GWh.

Siç vërehet në paraqitjen grafike ka një ecuri në ulje të Humbjeve në % nga viti në vit. Kundrejt vitit 2013 Humbjet janë reduktuar me afro 1 808 GWh ose rreth -27.1%. Humbjet në vlere absolute (MWh) krahasuar me të gjithë vitet paraardhese janë ulur ndjeshëm, duke arritur deri në reduktimin me afro 56.1 %, ulje krahasuar me vitin 2013.

Investimet në rrjetin e shpërndarjes, infrastrukture dhe në teknologji, organizimi i permiresuar i punes se stafëve në terren, efienca, analiza dhe monitorimit i ecurise se tyre, përmirësimi i cilësisë së kontrolleve kanë rezultuar në mekanizmat kryesore që kanë kontribuar në uljen e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Sic parashtruar edhe me lart ka një ecuri në ulje të Energjise së Humbur pavaresisht se Energjia e Qarkulluar në rrjetin e shperndarjes ne 3-4 vitet e fundit ka shenuar rritje te konsiderueshme kundrejt viteve te meparshem.

Viti 2024, ashtu si dhe u theksua me sipër ka një rritje të energjise së qarkulluar me +4% ose rreth +303 GWh me shume energji, ndersa humbjet jane ulur me -1.5% ose rreth 21.3 GWh me pak humbje ne rrjet krahasuar me vitin 2023.

Në tabelën e mëposhtme jepen humbjet për vitin 2024 në mënyrë të detajuar sipas:

- Drejtorive Rajonale
- Nivelit të tensionit TL, TM & TU
- Konsumi Vetjak në TL
- Nivel rrjeti OSSH.Sh.a

VITI 2024	Energji e Hyre në Rrjetin e Shpërndarjes (MWh)	Energji totale e përdorur (MWh)	Humbjet (MWh)	Humbjet (%)
Dr. Rajonale Tirane	2,699,138	2,397,449	301,690	11.18%
Dr. Rajonale Durres	996,164	822,044	174,120	17.48%
Dr. Rajonale Fier	493,583	431,661	61,922	12.55%
Dr. Rajonale Elbasan	518,678	448,887	69,791	13.46%
Dr. Rajonale Korce	400,927	347,303	53,625	13.38%
Dr.Rajonale Gjirokaster	341,166	282,180	58,986	17.29%

Dr. Rajonale Shkoder	738,123	501,727	236,396	32.03%
Dr. Rajonale Berat	449,398	379,984	69,414	15.45%
Dr. Rajonale Kukes	220,225	126,800	93,425	42.42%
Dr. Rajonale Burrel	522,485	397,209	125,276	23.98%
Dr. Rajonale Vlore	395,534	328,299	67,235	17.00%
TOTAL ZONAT	7,775,421	6,463,543	1,311,878	16.87%
Humbjet teknike ne TL	101,039	-	101,039	1.28%
Konsumi vetjak NjTL	4,553	4,553		-
Humbjet ne Shperndarje	7,881,013	6,468,095	1,412,918	17.93%

Siç evidentohet ne vijim, kontributin me te madh ne reduktimin e Humbjeve e ka dhene ulja e tyre ne segmentin TM&TU (pasi aty qarkullon rreth 98.5% e Energjise totale ne rrjet)

Viti 2024 ndaj vitit 2023.

Humbjet ne rrjetin e shperndarjes	Viti 2023	Viti 2024	Reduktimi Humbjeve
TM&TU	17.87%	16.87%	-1.00%
Tension Larte	1.30%	1.28%	-0.02%
Total OSSH. Sh.a	18.93%	17.93%	-1.00%

15.3 Objektivi mbi humbjet në rrjetin e shpërndarjes

Objektivi mbi Humbjet ne rrjetin e Shperndarjes per vitin 2025 eshte 18.1% sipas VKM Nr. 758, date 9.12.2021 "Per nje ndryshim ne Vendimin Nr. 253, date 24.4.2019, te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e Planit te Konsolidimit Financiar te Sektorit Publik, Elektroenergjitik".

VKM permendur më poshtë percakton/parashikon projeksionin vjetor te meposhtem mbi humbjet ne rrjetin e Shpendarjes dhe Mbledhjen e te Ardhurave per OSHEE Group per periudhen ne vazhdim deri ne vitin 2026.

VENDIM
Nr. 758, datë 9.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 253, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KONSOLIDIMIT
FINANCIAR TË SEKTORIT PUBLIK, ELEKTROENERGJETIK"

	Humbjet totale (%)	Mbledhja e të ardhurave (%)
2014	37.8	91.9
2015	31.3	98.3
2016	28.0	92.0
2017	26.4	97.0
2018	23.9	95.0
2019	21.8	95.0
2020	21.5	95.0
2021	20.5	95.0
2022	19.6	95.0
2023	19.0	
2024	18.5	
2025	18.1	
2026	17.8	

16. OPERIMIT DHE ANALIZËS SË RRJETIT SHPËRNDARËS

Departamenti i Operimit dhe Analizës së Rrjetit Shpërndarës në OSSH është përgjegjës për realizimin e funksioneve të tij në përputhje me Kodin e Shpërndarjes, sipas Nenit 3, Kapitulli "Operimi" të Vendimit ERE nr. 181, datë 10.11.2017, i cili përmban "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike". Në vitin 2024 dhe 2025, OSSH ka realizuar investime të rëndësishme për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, për të mundësuar përballimin e kërkesave në rritje për furnizimin me energji elektrike dhe për të garantuar që rrjeti të funksionojë në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë.

Përmbushja e funksioneve të këtij departamenti përfshin:

- Operimi i Sigurt i Sistemit të Shpërndarjes:
Sigurimi i funksionimit të sigurt të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, duke koordinuar dhe bashkëvepruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), prodhuesit e energjisë elektrike, nënstationet në administrim nga OSSH dhe dispeceritë TM/TU.

- **Mbledhja dhe Përpunimi i Të Dhënave:**
Mbledhja, regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave që lidhen me standardet e cilësisë së furnizimit dhe performancën e rrjetit shpërndarës. Për çdo periudhë tre-mujore, këto të dhëna raportohet në ERE dhe departamenti merr pjesë aktivisht në monitorimin e tyre nëse ky proces iniciohet nga ERE.
- **Monitorimi dhe Përditësimi i Kodit të Rrjetit:**
Monitorimi dhe përditësimi i kodeve të rrjetit për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë, duke përfshirë aktet detyruese që rrjedhin nga zbatimi i këtyre kodeve (rregullore, marrëveshje shërbimi dhe operationale). Kjo përfshin gjithashtu shkëmbimin e informacionit ndërmjet OSSH, OST, përdoruesve, furnizuesve, ERE-së, agjencive shtetërore dhe organizatave private që përfaqësojnë interesat e përdoruesve, si dhe bashkëpunimin me ECDSO-E lidhur me menaxhimin e tranzicionit të energjisë.

Këto procese realizohen në kuadër të strukturës së re të miratuar, e cila përfshin dy Drejtoritë dhe sektorët përkatës, si më poshtë:

Drejtoria e Operimit me sektorët:

- Sektori i Dispecerisë Qendrore TL
- Sektori i Operimit dhe Koordinimit të Rrjetit TM – TU
- Sektori i Planifikimit Operacional
- Sektori i Menaxhimit të Sistemit SCADA
- Sektori i Menaxhimit të Burimeve Gjeneruese

Drejtoria e Analizës së Rrjetit, Monitorimit, Zbatimit të Kodeve dhe Marrëdhënieve Rregullatore me sektorët:

- Sektori i Përpunimit të Të Dhënave të Cilësisë së Rrjetit
- Sektori i Monitorimit të Kodeve të Rrjetit dhe Marrëdhënieve Rregullatore

Në vitin 2024 janë realizuar detyrat përkatëse sipas funksioneve të secilit sektor, si më poshtë:

Sektori i Dispecerisë Qendrore TL:

Dispeceria e Tensionit të Lartë ka realizuar menaxhimin operativ të sistemit të shpërndarjes në rang vendi, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të shpërndarjes. Përmes trajnimeve dhe instruktimit të personelit, është arritur qëndrueshmëria e sistemit dhe kthimi sa më i shpejtë i energjisë elektrike tek konsumatorët.

- **Rregjistrimi i Ndërprerjeve:**
Të gjitha ndërprerjet në rrjetin TL/Nst janë regjistruar në mënyrë korrekte në librat operativë dhe janë transferuar në tabela Excel sipas formateve përkatëse.
- **Monitorimi dhe Menaxhimi i Ngarkesave Maksimale:**
Sektori ka monitoruar dhe menaxhuar ngarkesat maksimale gjatë periudhave ekstreme, si gjatë fillimit të vitit 2024, sezonit veror dhe periudhës me kushte atmosferike të këqija. Në çdo ngjarje

janë marrë masa për të siguruar furnizim të pandërprerë me energji për konsumatorët, përmes planeve të gatishmërisë.

- **Evidentimi dhe Adresimi i Pikave Kritike:**
Janë evidentuar pikat kritike të rrjetit shpërndarës dhe janë adresuar ato në departamentet përkatëse për investime dhe përmirësime.
- **Përmbushja e Detyrimeve dhe Udhëzimeve nga Dispeceria e OST-së:**
Janë zbatuar në mënyrë të saktë të gjitha udhëzimet e marra nga Dispeceria e OST-së, bazuar në Kodet e Shpërndarjes dhe Transmetimit, duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik shqiptar, veçanërisht gjatë periudhave të prodhimit të lartë të energjisë nga HEC-et.
- **Menaxhimi i Stakimeve dhe Remontimeve:**
Janë zbatuar me korrektësi procedurat për grumbullimin, përpunimin dhe mbikëqyrjen e planit grafik të remonteve, si për sistemin e transmetimit të OST-së, ashtu dhe për planin e DTL-së. Janë realizuar rakordimet për të minimizuar stakimet gjatë remonteve dhe janë zbatuar afatet e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara.
- **Investimet dhe Remontet në Pikën e Dobët të Rrjetit:**
Janë identifikuar pikat e dobëta në nënstacionet dhe linjat 35 kV që kërkojnë investime ose remonte të thella në vitet në vijim. Po ashtu, janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve në shkresat e adresuara këtij sektori.

Spektori i Operimit dhe Koordinimit të Rrjetit TM-TU:

Ky sektor ka realizuar me sukses grumbullimin dhe raportimin në kohë reale të stakimeve të rrjetit TM/TU gjatë vitit 2024, veçanërisht gjatë periudhave të gatishmërisë për shkak të kushteve atmosferike të këqija, mbingarkesave për shkak të temperaturave të ulëta dhe aktiviteteve të tjera në rang vendi.

Fale insistimit dhe këmbënguljes, është disiplinuar procesi i grumbullimit dhe menaxhimit të remonteve në rrjetin TM/TU për të gjitha Drejtoritë Rajonale. Procesi i grumbullimit të stakimeve dhe përpunimi i tyre sipas formulave përkatëse ka qenë i suksesshëm. Janë identifikuar dhe evidentuar pikat e dobëta në linjat TM, kryesisht ajrore, si dhe në kabinat shpërndarëse, për të cilat do të nevojiten investime dhe remonte të thella në vitin në vijim. Po ashtu, janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve për shkresat e adresuara këtij sektori.

Spektori i Planifikimit Operacional:

Gjatë vitit 2024, janë realizuar takime dhe komunikime shkresore me ERE për problematika të ndryshme lidhur me furnizimin me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit. Po ashtu, janë zhvilluar takime dhe korrespondencë me OST, OSHEE, DTL, dhe Drejtoritë Rajonale për të trajtuar problematika të ngjashme, kryesisht gjatë periudhave të gatishmërisë.

Një tjetër hap i rëndësishëm ka qenë mbajtja e korrespondencës me Departamentin Ligjor për të pasur opinione dhe procedura sa më të qarta dhe të sakta nga ana ligjore. Për më tepër, është realizuar monitorimi i zhvillimeve në rrjetin shpërndarës dhe janë përditësuar problematikat në lidhje me zbatimin e Kodit të Shpërndarjes. Po ashtu, ka nisur puna për institucionalizimin e adresave për njoftimet në rastet e ndërprerjeve në rrjetin shpërndarës dhe përditësimin e të dhënave teknike për rrjetin shpërndarës në programin Power Factory.

Spektori i Menaxhimit të Sistemit SCADA:

Projekti "Programi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike – Lot 1: SCADA" është ende në fazën e zhvillimit. Gjatë vitit 2024, sektori i menaxhimit SCADA ka realizuar disa hapa të rëndësishëm, përfshirë:

- Përgatitja e Databazës: Janë mbledhur dhe organizuar të dhënat teknike për pajisjet primare që do të afishohen në sistemin SCADA, të cilat janë detajuar në një databazë për nënstacionet përkatëse.
- Rishikimi i Skemave Primare: Janë realizuar korrigjime dhe ndryshime të emërtimeve dhe parametrave sipas një standarti të unifikuar.
- Mbledhja e Të Dhënave për Linjat 110kV: Janë mbledhur të dhëna për linjat që do të furnizojnë nënstacionet që do të integrohen në sistemin SCADA.
- Matjet e Fuqisë Aktivë dhe Reaktive: Sektori ka realizuar matje të fuqive aktive dhe reaktive në pikun e ngarkesave për të gjitha nivelet e tensioneve. Këto matje janë përpunuar dhe dërguar për testim nga kompania SIEMENS.

Spektori i Menaxhimit të Burimeve Gjeneruese:

Ky sektor ka realizuar ndërtimin dhe përditësimin e databazës së gjeneruesve të lidhur në sistemin e shpërndarjes, në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit të Rrjetit. Janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve për ankesat e gjeneruesve lidhur me stakimet dhe koordinimi me DTL, Dispecerinë TL, dhe Dispecerinë TM/TU ka qenë në nivelin e duhur.

Gjithashtu, është realizuar përpunimi i dokumentacionit teknik për punonjësit e OST, prodhuesit dhe konsumatorët në TL, DTL, Drejtoritë Rajonale dhe në përputhje me Kodin e Shpërndarjes, Rregulloren e Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik, si dhe proceset dhe procedurat përkatëse.

Spektori i Përpunimit të Të Dhënave të Cilësisë së Rrjetit:

Ky sektor ka realizuar grumbullimin dhe përpunimin në mënyrë të saktë të stakimeve të rrjetit shpërndarës TL/TM/TU dhe ka përllogaritur treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancës së rrjetit, siç kërkohet nga Vendimi ERE nr. 181, dt. 10.11.2017 dhe Vendimi nr. 97, dt. 07.04.2021. Treguesit përfshijnë:

- **SAIDI:** Koha e stakimeve për konsumator
- **SAIFI:** Frekuenca e ndërprerjeve për konsumator
- **Koha e Riparimit të Difektit**
- **Niveli i Frekuencës**
- **Niveli i Tensionit**
- **Energjia e Pa Furnizuar**

Këto tregues janë përllogaritur në mënyrë mujore dhe për periudha progresive 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore, si dhe performanca vjetore për vitin 2024.

PERIUDHA Janar- Dhjetor 2024						
Emertimi I rrjetit	SAIFI		SAIDI		Ndryshimi ne % SAIDI	Ndryshimi ne % SAIFI
	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2024		
Total TL	7.86	6.29	11.87	11.63	2.0%	20.0%
Total TM	21.60	19.65	36.70	32.05	12.7%	9.1%
Total TU	1.37	1.33	1.61	1.45	9.6%	2.5%
Total OSSH	30.86	27.26	50.18	45.13	10.1%	11.7%

Është realizuar gjithashtu llogaritja e parashikimit të treguesve të performancës që duhet të arrihen, në përputhje me planin e investimeve dhe të mirëmbajtjes, sipas tabelës së mëposhtme:

Emertimi	Permiresimi ne % I SAIF-It	Permiresimi ne % I SAID- it
Rrjeti TL- N/st	0.5%	0.4%
Ndertim Rrjeti TM	5.4%	4.6%
Rikonstrukcion Rrjeti TM /TU	5.5%	4.9%
Investime prioritare (Rrjet TU - ABC lines)	6.8%	9.5%
Total OSSH 2025	4.0%	3.4%

Të gjitha afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve të shkresave adresuar këtij sektori janë zbatuar në mënyrë të saktë. Nga analizimi i treguesve të cilësisë së furnizimit, del e qartë se investimet e OSSH duhet të përqendrohen kryesisht në rrjetet TM dhe TU. Ky fokus do të mundësojë një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së furnizimit dhe performancës së këtyre rrjeteve në vitet në vijim.

Spektori i Monitorimit të Kodeve të Rrjetit dhe Marrëdhënieve Rregullatore:

Në bashkëpunim me Grupin e Punes të caktuar për këtë qëllim, po vijon puna për realizimin e ndryshimeve të nevojshme, bazuar në propozimet e palëve të përfshira, dhe miratimin e Kodit të Ri të Shpërndarjes. Gjatë këtij procesi, është mbajtur korrespondencë të rregullt me OST, ERE, njësitë gjeneruese dhe të gjitha palët e interesuara, për çdo çështje të lidhur me cilësinë e furnizimit dhe afatet e njoftimeve në rastet e ndërprerjeve.

Sipas kërkesave, janë dërguar komentet përkatëse në lidhje me raportet e dërguara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, veçanërisht për problemet teknike me të cilat përballet Sistemi i Operimit.

Objektivat për vitin 2025:

- **Miratimi i Kodit të Ri të Shpërndarjes** (Pjesa më e madhe e punës është realizuar përmes bashkëpunimit ndërmjet OSSH dhe OSSHE, dhe ndodhet në fazën përfundimtare për të kaluar në procesin e miratimit sipas ligjit).
- Implementimi i SCADA-s qendrore me KfW.
- Implementimi i platformës së Dispecerisë për TL dhe TM/TU.
- Trajnime të ndryshme për stafin për teknologjitë e reja që do të implementohen.

- Ristrukturimi i Drejtorive Rajonale për të mundësuar ndarjen e proceseve të Operimit nga ato të Mirëmbajtjes.
- Progresi punës për evidentimin e problematikave të ndryshme të rrjetit (TL/TM/TU) dhe raportimin e tyre në sektorët përkatës për marrjen e masave të ndërhyrjes.
- Përmirësimi i treguesve të cilësisë së rrjetit (SAIDI/SAIFI), bazuar në planin e investimeve dhe planin e mirëmbajtjes. SAIFI -4.0%, SAIDI - 3.4%.
- Bashkërendimi i punës me Drejtoritë Rajonale për menaxhimin më të mirë të rrjetit TM/TU dhe të burimeve gjeneruese të lidhura me këtë rrjet, si dhe njoftimet paraprake të gjeneruesve për raste avarie ose remonresh të fidrave.
- Vazhdojmë punën për plotësimin e të dhënave në sistemin Power Factor.

Ky material ka për qëllim të pasqyrojë progresin dhe planet për të ardhmen, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të proceseve dhe teknologjive të përdorura.

17. PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE, REMONTET DHE MIREMBAJTJA E RRJETIT

Shoqëria OSSH Sha ka zbatuar në mënyrë të përpiktë gjatë vitit 2024 të gjitha procedurat dhe rregulloret që lidhen me kryerjen e remonteve, riparimin e defekteve dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Gjatë këtij periudhe, janë zbatuar pa asnjë devijim procedurat, rregulloret dhe legjislacioni në fuqi, duke përfshirë:

- Rregullorja e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike.
- Kodi i Shpërndarjes Nr. 100, datë 26.08.2008.
- Vendimi Nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar nga Nr. 177, datë 08.11.2016, lidhur me Lidhjet e Reja.
- Vendimi Nr. 137-2017, si dhe Fletorja Zyrtare e vendimit Nr. 4 e Këshillit të Lartë të Arkivave.
- Ligji Nr. 43, datë 2015, i përditësuar në vitin 2018.
- Ligji Nr. 61, datë 2020.
- Marrëveshja Nr. 9825 protokoll, datë 24.12.2020, për "Ofrimin e Shërbimeve midis shoqërive OSHEE sha dhe OSSH sha".
- Marrëveshja e Shërbimit të Shpërndarjes ndërmjet OSSH sha dhe Furnizuesve të Energjisë Elektrike.

Gjatë vitit 2024, OSSH sh.a. ka vijuar angazhimin në realizimin e investimeve të rëndësishme në rrjetin e shpërndarjes, me fokus në përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë, duke siguruar jo vetëm zëvendësimin e pajisjeve të dëmtuara, por edhe implementimin e masave afatgjata që do të kontribuojnë në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e menaxhimit të rrjetit.

17.1 Objektivat e Planifikimit të Investimeve

Investimet e realizuara gjatë vitit 2024 kanë si qëllim kryesor:

- Sigurimi i qëndrueshëm dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, për të mbështetur rritjen e ngarkesës dhe kërkesat e tregut.

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale, përmes optimizimit të proceseve dhe përmirësimit të pajisjeve.
- Rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit dhe sistemeve të matjes, me fokus në rritjen e efikasitetit dhe kontrollin mbi shpërndarjen e energjisë.

17.2 Strategjia e Planifikimit për realizimin e objektivave

Strategjia e implementuar për vitin 2024 ka përfshirë disa masa të rëndësishme, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e kapaciteteve dhe performancës të rrjetit të shpërndarjes, siç vijon:

- Rritja e kapaciteteve të nënstacioneve ekzistuese dhe ndërtimi i nënstacioneve të reja, për të përballuar kërkesat në rritje.
- Zgjerimi i rrjetit 35 kV, për të adresuar kufizimet e rrjedhjes së ngarkesës dhe për të përmirësuar cilësinë e furnizimit me energji elektrike.
- Investime në rrjetin 10kV dhe 6kV, me qëllim ndarjen e ngarkesave në fiderat dalës dhe përmirësimin e infrastrukturës në zonat rurale dhe periferike.
- Modernizimi i kabinave dhe linjave të transformimit, duke kaluar nga 10kV dhe 6kV në 20kV për të ulur humbjet teknike.
- Rritja e sigurisë dhe saktësisë në matje, me futjen e teknologjive të reja që kontribuojnë në mbrojtjen dhe ruajtjen e sistemit të matjes.

17.3 Bazat Ligjore për Planifikimin e Investimeve

Investimet janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 135, datë 06.09.2017, për “Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

17.4 Investimet e Realizuara dhe Proçesi i Zbatimit

Gjatë vitit 2024 janë realizuar investime të rëndësishme në infrastrukturë, të cilat përfshijnë:

- Ndërtimi i nënstacioneve të reja dhe fuqizimi i atyre ekzistuese.
- Rikonstruksione dhe fuqizime të rrjetit TM 20 kV.
- Ndërtimi i kabinave elektrike të reja dhe rikonstruksioni i kabinave ekzistuese (tip kullë, shtyllore etj.).
- Ndërtimi i rrjetit TU me përcjellës ABC, që do të përmirësojë ndarjen e energjisë dhe do të zvogëlojë humbjet.
- Rikonstruksioni i linjave TL, për të përmirësuar kapacitetet dhe stabilitetin e rrjetit.
- Investime në sisteme matëse, me qëllim rritjen e cilësisë së matjes dhe uljen e humbjeve përmes përdorimit të teknologjive modern, Realizimi i investimeve të shprehur në natyrë për kontratat e realizuara gjatë vitit 2024 dhe në proçes realizimi gjatë vitit 2025.

Investimet 2023-2024	Fuqizim/ Rikonstrukcion Nënstacioni	Linjë TM Kabllore (km)	Rekonstrukcion TM Ajrore (km)	Linja TU "ABC" (km)	Kabina te Reja + Rikonstrukcion
Në natyrë (kontrata të realizuara në vitin 2024)		145	210	516	199
Në natyrë (kontrata të lidhura në 2024 në proces realizimi në vitin 2025)	11	265	388	965	470

RAJONI TIRANËS

Gjatë vitit 2024, në rajonin e Tiranës janë përfunduar disa investime të rëndësishme në infrastrukturën e shpërndarjes së energjisë elektrike. Këto investime synojnë përmirësimin e cilësisë së furnizimit dhe optimizimin e rrjetit, duke zëvendësuar pajisjet dhe kabinat e vjetra, dhe duke rritur kapacitetet për të përballuar kërkesat e rritura për energji elektrike. Investimet e realizuara përfshijnë;

Ndërtimi i kabinave dhe linjave TM 20 kV me furnizim nga fideri R3 i Nënstacionit Vorë dhe nga fiderat F8 dhe F32 të Nënstacionit Kashar, të cilat zëvendësojnë kabinat 6 kV të fiderit Gjokaj të Nënstacionit Vorë.

1. Linjë TM 20 kV dhe ABC në vazhdim të fiderave të rinj të Vorës, duke përmirësuar shpërndarjen e energjisë në këtë zonë.
2. Fider i ri 20 kV E13 nga Nënstacioni Farkë 110/20/10 kV, i cili do të kontribuoni në përmirësimin e furnizimit me energji.
3. Kalimi i Fiderit C6 nga linja ajrore në kabllore, përfshirë kabinat elektrike të Pasho Hysit, Anxhelo Kazës, Idriz Dollakut 2, Idriz Kollakut 1 dhe rrjeti TU i kabinës K2 në Nënstacionin Traktora, duke optimizuar rrjetin dhe ulur humbjet teknike.
4. Zëvendësimi i fiderave 6 kV të Mezes me 20 kV, duke u furnizuar nga fideri 32 i Nënstacionit Kashar, për të përmirësuar cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me energji.
5. Faza e dytë e zgjerimit dhe rikonstrukcionit të fiderit E10 në zonën e Berzhitës, përfshirë ndërtimin e rrjetit TU me përcjellës ABC, që do të ndihmojë në përmirësimin e shpërndarjes në këtë zonë.
6. Kalimi i Fiderit 118 nga Nënstacioni Kinostudio 35/6 kV në rrjetin e ri 20 kV, për të rritur kapacitetet dhe stabilitetin e rrjetit në këtë zonë.
7. Ndërtimi i 12 kabinave të reja shtyllore dhe linjat përkatëse TM në Fiderin F4 të Nënstacionit 35/6 kV Ndroq, si dhe linjat TU me kabell ABC për 18 kabina të tjera, për të rritur mbulimin dhe efikasitetin në këtë zonë.
8. Ndërtimi i dy kabinave të reja dhe rrjeti TU në zonën e Dajti, për të përmirësuar furnizimin me energji për konsumatorët në këtë zonë malore.
9. Instalimi i Sistemit të Matjes Inteligjente të Bilancit të Energjisë në kabinat elektrike TM-TU dhe për konsumatorët privatë, si dhe integrimi i tyre me platformën MDM, për të mundësuar monitorim dhe menaxhim të avancuar të konsumit të energjisë.

RAJONI BURREL

Në vitin 2024, në rajonin e Burrelit janë realizuar disa investime të rëndësishme në infrastrukturën e shpërndarjes së energjisë elektrike, për të përmirësuar cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me energji. Investimet e përfunduara janë:

1. Rikonstruksioni i rrjetit TU 0.4 kV me kabëll ABC në Njësinë Peshkopi, Drejtoria Rajonale Burrel, për zonat Guri i Kuq, Bellova dhe Pularia. Ky investim ka kontribuar në përmirësimin e rrjetit dhe uljen e humbjeve teknike në këto zona.
2. Rikonstruksioni i rrjetit TU 0.4 kV me kabëll ABC në Njësinë Kurbin, Drejtoria Rajonale Burrel, për zonat Mamurras-Milot, duke rritur efikasitetin e rrjetit të shpërndarjes.
3. Rikonstruksioni i rrjetit TM, përfshirë Fiderin Shupenzë NR 2 dhe Nënstacionin Shupenzë, si dhe Fiderin Zall Dardhë dhe Nënstacionin Fushë Alie (Loti I dhe Loti II). Ky projekt ka përmirësuar fuqizimin dhe stabilitetin e rrjetit të transmetimit në këtë zonë.

RAJONI SHKODËR

Në vitin 2024, janë realizuar disa investime të rëndësishme në infrastrukturën e shpërndarjes së energjisë elektrike në Rajonin e Shkodrës, për të përmirësuar cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me energji. Disa nga investimet e përfunduara janë:

1. Ndërtimi i kolektorit kabllor dhe Nënstacionit Plazh Velipojë, përfshirë ndërtimin e fiderave kabllorë 20 kV F1 dhe F2, kabinave 20 kV dhe rrjetit TU me kabëll ABC. Ky projekt ka përmirësuar kapacitetet e rrjetit në këtë zonë bregdetare.
2. Kalimi nga 10 kV në 20 kV për rrjetin TM dhe rikonstruksioni i kabinave dhe rrjetit TU me kabëll ABC në fiderin F-16, Nënstacioni Lezhë. Ky investim ka rritur stabilitetin dhe cilësinë e furnizimit për zonën përkatëse.
3. Kalimi nga 10 kV në 20 kV për rrjetin TM dhe rrjetin TU me kabëll ABC, përfshirë kabinat në fiderin F-17, Nënstacioni Lezhë. Ky projekt ka përmirësuar kapacitetet dhe ka zvogëluar humbjet teknike në rrjet.
4. Kalimi nga 10 kV në 20 kV për rrjetin TM dhe rrjetin TU me kabëll ABC, përfshirë kabinat në fiderin F-18, Nënstacioni Lezhë. Ky investim ka kontribuar në forcimin e rrjetit dhe në rritjen e efikasitetit të furnizimit me energji.

RAJONI KUKËS

Në vitin 2024, janë realizuar investime të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së energjisë në Rajonin e Kukësit. Disa nga investimet e përfunduara janë:

1. Rikonstruksioni i pjesshëm i Fiderit Ujësjellës, Nënstacioni 110/10 kV, Bajram Curri. Ky investim ka përmirësuar performancën dhe stabilitetin e furnizimit me energji për zonat përkatëse.
2. Rikonstruksioni i rrjetit TM, Nënstacioni Shoshan dhe Shoshan-Valbonë, Fideri Ujësjellës, Nënstacioni 110/10 kV, Bajram Curri. Ky projekt ka kontribuar në forcimin e rrjetit të transmetimit dhe ka rritur efikasitetin e furnizimit me energji.

RAJONI BERAT

Në vitin 2024, janë realizuar investime të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së energjisë në Rajonin e Berat. Disa nga investimet e përfunduara janë:

1. Rikonstruksioni i Fiderit të Tomorricës TM/TU, i cili ka përmirësuar performancën e rrjetit dhe ka rritur stabilitetin e furnizimit me energji në këtë zonë.
2. Ndërtimi i kabinave të reja "Banaj 4" dhe "Banaj 5", si dhe ndërtimi i rrjetit TU me kabëll ABC. Ky projekt ka përmirësuar infrastrukturën dhe ka rritur kapacitetin e rrjetit të shpërndarjes.

RAJONI DURRËS

Në vitin 2024, janë realizuar investime të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës së energjisë elektrike në Rajonin e Durrësit. Disa nga investimet që kanë përfunduar janë:

1. Zgjatimi i Fiderit 8 me kabina dhe rrjet të ri TU, Nënstacioni Fushë Krujë 110/20 kV (drejtim Bubqit). Ky projekt ka zgjeruar dhe përmirësuar rrjetin e energjisë në këtë zonë.
2. Blerja e matësve dhe aksesorëve për sistemin e matjes, për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e konsumit të energjisë.

RAJONI KORÇË

Në vitin 2024, janë realizuar disa investime të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike në Rajonin e Korçës. Disa nga projektet që kanë përfunduar janë:

1. Rrjeti TU me kabell ABC në fshatin Qinam, Agjensia Ersekë, Rajoni Korçë, që ka përmirësuar furnizimin me energji elektrike në këtë zonë.
2. Rrjeti TU me kabell ABC në fshatin Selenicë, Agjensia Ersekë, Rajoni Korçë, një tjetër investim që ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës elektrike në këtë zonë.
3. Rrjeti TU me kabell ABC për kabinat Rehovë 1 dhe 2, i cili ka përmirësuar më tej infrastrukturën elektrike në rajon.

RAJONI GJIROKASTËR

Gjatë vitit 2024, janë përfunduar disa projekte të rëndësishme që kanë përmirësuar infrastrukturën e energjisë elektrike në Rajonin e Gjirokastrës. Disa nga investimet përfshijnë:

1. Ndërtimi i rrjetit kabllor 20 kV, Fiderat F8, F9, F10, Nënstacioni Gjirokastrë 110/35/20kV (Zona Kardhiq) – Faza 1. Ky investim ka përmirësuar furnizimin me energji në këtë zonë.
2. Ndërtimi i linjës kabllore 20 kV për furnizimin e tunelit të Skerficës, që ka mundësuar furnizim të qëndrueshëm për këtë infrastrukturë të rëndësishme.
3. Rikonstruksion i kabinave dhe linjave TU me kabëll ABC për fiderat Kardhiq dhe Lunxhëri, Nënstacioni Gjirokastrë 110/35/6 kV. Ky projekt ka përmirësuar sigurinë dhe efikasitetin e rrjetit të energjisë elektrike.

4. Zgjatimi i fiderit OLM 6 dhe OLM 5, 6 kV dhe 20 kV, N/Stacioni Sarandë 110/20 kV, që ka përfshirë lidhjen unazore dhe rikonstruksionin e rrjetit të energjisë për zonat e Ksamilit dhe Marinës.

RAJONI FIER

Gjatë vitit 2024 në Rajonin e Fier ka nisur zbatimi i investimit:

1. Ndërtimi i Nënstacionit të Ri Fier 2 110/20 kV – Ky investim është në proces realizimi nga DTL dhe ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës së energjisë elektrike në rajon, duke siguruar një furnizim më të qëndrueshëm dhe efikas për zonën e Fierit.

RAJONI VLORË

Investimet e përfunduara gjatë vitit 2024:

1. Ndërtimi i linjës kablllore 20 kV, N/St Orikum – Tuneli Llogarase – Ky investim ka për qëllim sigurimin e një lidhjeje më të fortë dhe të qëndrueshme për furnizimin me energji elektrike të zonës së Orikumit dhe Tunelit të Llogarasë.
2. Ndërtimi i linjës ajrore 20 kV, N/St Palase – Tuneli Llogarase – Po ashtu, ky projekt përmirëson furnizimin me energji për zonën e Palasës dhe Tunelit të Llogarasë.
3. Ndërtimi i Fiderave 20 kV, L10, N/St Vlora 1 dhe Fideri J10 N/St Vlora 2 për furnizimin e objekteve në Portin e Vlorës – Ky investim ka siguruar furnizim më të mirë me energji për Portin e Vlorës, duke mbështetur zhvillimin e aktiviteteve portuale dhe industrisë në këtë zonë.

Plani i investimeve i realizuar gjatë vitit 2024, shprehur në natyrë sipas Rajoneve

Rajonet	OSSH sh.a.								
	Rrjeti TM 20/10 kV		ABC (km)	Kabinat			Nënstacione		N. Aboneteve
	Rrjeti TM 20/10kV Kabell (km)	Rrjeti TM 20/10kV Ajore (km)		Box (cope)	Rikonstruksion (cope)	Ajroe (cope)	Reja (cope)	Rikonstruksion (cope)	
	(km)	(km)	(km)	(cope)	(cope)	(cope)	(cope)	(cope)	
Tirana	43.20	5.20	148.83	27	4	9	-	-	7,616
Durresi	5.40	40.04	84.88	24	6	19			7,152
Elbasan	0.20	95.88	269.45	-	18	12			5,490
Fier	8.90	49.79	55.16	5	22	15		1	8,760
Korce	-	0.53			98				22,328
Shkoder	25.17	0.05	25.90	37	6	3			1,530
Burrel	-	5.20	105.60	-	32	3			2,274
Vlore	44.58	2.40	52.51	44	6	-		1	1,190

Gjirokaster	17.90	-	26.12	4	34	1	2		15,643
Berat	2.30	35.60	166.29	1	92	12			13,293
Kukes	-	0.72	53.00	-	-	2			1,310
TOTAL	147.65	235.41	987.73	142	318	76	2	2	86,586

Paraqitja grafike përsa më sipër:

17.5 Aplikimet për Lidhje të Reja dhe Shtesë Fuqie gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar një numër të konsiderueshëm aplikimesh për lidhje të reja dhe shtesë fuqie, të cilat janë kategorizuar sipas niveleve të ndryshme të fuqisë. Aplikimet janë klasifikuar në përputhje me kërkesat dhe kërkesat për rritjen e kapacitetit të furnizimit me energji elektrike.

Në përputhje me këto aplikime, është realizuar një proces shqyrtimi nga autoritetet përkatëse dhe janë miratuar çmimet për secilën lidhje në bazë të tarifave të miratuara nga ERE.

Ky proces ka për qëllim të sigurojë një menaxhim të qartë dhe të drejtë të lidhjeve të reja, duke mundësuar rritjen e kapacitetit të infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Fuqia/Lloji i aplikimit	Lidhje e re	Shtese Fuqie	Total
0-20 KW	12327	2067	14394
20-50 kw	638	1009	1647
Mbi 50 KW	780	715	1495
Total	13745	3791	17536

Aplikimet totale të regjistruara gjatë vitit 2024 për lidhje të re dhe shtesë fuqie sipas kategorizimeve të rajoneve dhe fuqive figurojnë si më poshtë:

Rajoni/Fuqia	0-20 kw	20-50 kw	mbi 50 kw	Total
Drejtoria Rajonale Berat	919	81	69	1069
Drejtoria Rajonale Burrel	592	24	48	664
Drejtoria Rajonale Durrës	2785	237	239	3261
Drejtoria Rajonale Elbasan	870	93	94	1057
Drejtoria Rajonale Fier	609	85	120	814
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë	995	168	87	1250
Drejtoria Rajonale Korce	505	38	54	597
Drejtoria Rajonale Kukes	388	26	8	422

Drejtoria Rajonale Shkodër	1315	174	119	1608
Drejtoria Rajonale - Tiranë	4277	556	554	5387
Drejtoria Rajonale Vlorë	1139	165	103	1407
Total	14394	1647	1495	17536

17.6 Statusi i aplikimeve të kryera gjatë vitit 2024:

Statusi i aplikimeve	Numri i aplikimeve
Raste në të cilat aplikanti duhet të plotësojë dokumentacionin	1672
Perfunduar	11673
Pritet të bëhet pagesa e preventivit nga abonenti	816
Proces	2215
Refuzuar	1160
Total	17536

Arsyet e Aplikimeve të Pambyllura dhe të Refuzuara gjatë vitit 2024

Për aplikimet e pambyllura brenda afateve, faktorët që kanë ndikuar kryesisht përfshijnë:

- Koha e plotësimit të dokumentacionit nga abonenti, veçanërisht kur konstatohen mungesa të dokumenteve të nevojshme.
- Mosprania e abonentit në objekt gjatë azhurnimit teknik, i cili është një proces i rëndësishëm për përfundimin e lidhjeve.
- Pagesa e abonentit, e cila duhet të kryhet brenda një periudhe prej 7 ditësh.
- Kohëzgjatja e punimeve të përfundimit nga abonenti, si përfundimi i objektit dhe shtrirja e linjës, që ndikon në mbarëvajtjen e lidhjes.

Këto probleme, për të cilat afatet nuk varen drejtpërdrejt nga OSSH sh.a., janë të lidhura me faktorë të jashtëm që duhet të menaxhohen nga abonenti.

Sa i përket aplikimeve të kaluara në "hold" ose të **refuzuara**, arsyet përfshijnë:

- Mungesë dokumentacioni të plotë nga aplikanti.
- Pagesa e preventivit nuk është kryer për një periudhë të gjatë.
- Aplikanti ka detyrime të papaguara, duke e bërë të pamundur përpunimin e aplikimit.
- Objekti për të cilin është aplikuar është i papërfunduar, duke ndikuar në mundësinë për lidhjen e energjisë.
- Probleme mbi pronësinë, të cilat pengojnë zhvillimin e lidhjes.

Çmimet e Miratuara nga ERE për Lidhjet e Reja – Vendimi/ERE

Në përputhje me Vendimin e ERE Nr. 145, datë 19.07.2024, i cili lidhet me Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, janë përcaktuar tarifat për lidhjet e reja dhe shtesat e fuqisë. Ky vendim ka për qëllim standardizimin dhe përcaktimin e kushteve të lidhjeve të reja për abonentët, duke siguruar një procedurë të qartë dhe të drejtë për trajtimin e aplikimeve.

Sipas këtij vendimi, tarifat e lidhjeve të reja kanë mbetur të pandryshuara dhe vijojnë të jenë të njëjta si ato të miratuara më parë. Ky vendim siguron që të gjitha aplikimet për lidhje të reja, pa marrë parasysh natyrën e tyre (për konsumatorë të rinj ose shtesë fuqie), do të ndiqen sipas po të njëjtave kushte tarifore dhe procedurale, duke ruajtur transparencën dhe barazinë për të gjithë aplikantët.

Në këtë kuadër, tarifa për lidhjet e reja është përcaktuar për t'iu përshtatur kostove të mundshme të shërbimit dhe punimeve të realizuara, duke siguruar që nuk ka ndryshime nga tarifat e miratuara në vendimet e mëparshme.

Burimet Gjeneruese dhe Kapacitetet e Shpërndarjes për Përballimin e Kërkesës së Energjisë nga Burimet e Rinovueshme (PV, EOLIKE)

Sektori i Burimeve Gjeneruese

Sektori i Burimeve Gjeneruese ka për qëllim zhvillimin dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin e shpërndarjes, duke ndjekur një sërë procedurash dhe ligjesh të miratuara për të siguruar mbështetje për energjinë e gjeneruar nga burime të tilla si energjia diellore (PV) dhe ajo e erës (EOLIKE).

Në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 822/2015, sektori i Burimeve Gjeneruese zhvillon procedurat për miratimin e lidhjeve të burimeve të reja gjeneruese në rrjetin e shpërndarjes. Ky proces përfshin dhënien e opinionëve paraprake dhe miratimin e pikës së lidhjes për projektet që zhvillohen nga investitorët e rinj.

Gjithashtu, sektori ndjek procedurat për miratimin e lidhjeve për konsumatorët vetëprodhues të energjisë elektrike, të cilët përdorin burime të rinovueshme, në përputhje me udhëzimin Nr. 3, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”. Ky udhëzim ka për qëllim integrimin e këtyre konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes të OSSH sh.a.

Veprimtaritë e Sektorit të Burimeve Gjeneruese për Vitin 2024

Për vitin 2024, Sektori i Burimeve Gjeneruese ka fokusuar aktivitetin e tij në tre drejtime kryesore, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara për Drejtorinë e Ofrimit të Rrjetit:

1. Integrimi i Konsumatorëve Vetëprodhues në Rrjetin e OSSH sh.a: Ky proces është i bazuar në udhëzimin Nr. 3, datë 20.6.2019 dhe ka për qëllim përfshirjen e projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga burime të tilla si energjia diellore.

2. Dhënia e Opinioneve Paraprake për Lidhjet në Rrjet: Sipas Vendimit Nr. 822, datë 7.10.2015, sektori ofron opinione paraprake për projektet e reja gjeneruese, duke e mundur zhvillimin e mëtejshëm të tyre brenda infrastrukturës ekzistuese të shpërndarjes.
3. Miratimi i Pikës së Lidhjes për Burimet Gjeneruese: Sektori siguron miratimin e pikës së lidhjes për burimet gjeneruese, bazuar në Ligjin Nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 7/2017, duke mundur kështu integrimin e këtyre burimeve në rrjetin e shpërndarjes.

Përgjatë vitit 2024, sektori ka miratuar gjithsej **7 klientë Vetëprodhues**, të cilët aktualisht kanë një kapacitet të instaluar të përgjithshëm prej **60,596.26 kWp**. Ky progres tregon rritjen e interesit dhe investimeve në burimet e rinovueshme, duke kontribuar në diversifikimin dhe forcimin e kapaciteteve të energjisë elektrike nga burime të pastra dhe të qëndrueshme.

17.7 Numri i konsumatorëve vetëprodhues dhe fuqia totale e instaluar në kWp të lidhur në rrjetin e OSSH sipas drejtorive rajonale, viti 2024

Drejtoria Rajonale	Numri i veteprodhuesve 2024	Fuqia e instaluar (kW)
Tiranë	246	18551.007
Durrës	163	12757.88
Fier	36	2957.62
Vlorë	29	2329.625
Gjirokastrë	19	879.39
Korçë	41	1924.93
Elbasan	103	3739.09
Burrel	36	3442.02
Berat	61	4644.68
Shkodër	111	5295.71
Kukës	13	757.63
Totali	723	60559.81

17.8 Dhënia e Opinioneve Paraprake

Sektori i Burimeve Gjeneruese ka një rol kyç në garantimin e aksesit të drejtë dhe të sigurtë në rrjetin e shpërndarjes, duke siguruar që lidhjet e reja të bëhen në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Ky proces është i përkufizuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, aktet ligjore të tjera në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

Çdo përdorues i sistemit të shpërndarjes, që ka kërkesë për lidhje me rrjetin e shpërndarjes, duhet të plotësojë një sërë kërkesash teknike minimale për planifikimin dhe operimin, me qëllim që të sigurohet një përdorim i qëndrueshëm dhe i sigurtë i infrastrukturës së shpërndarjes. Ky proces ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit dhe stabilitetit të rrjetit gjatë integritetit të burimeve të reja gjeneruese.

Në përputhje me VKM Nr. 822/2015, neni 10, që përmend procedurën e studimit të parafsisibilitetit, çdo subjekt që kërkon lidhjen e një burimi të ri gjenerues në rrjetin e shpërndarjes është i detyruar të paraqesë

një kërkesë pranë OSSH sha për Opinion Paraprak mbi lidhjen e tij me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, OSSH sha ka dhënë gjithsej 42 opinione paraprake (si faza e parë e procesit për marrjen e miratimit paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës) për lidhjen e burimeve të reja gjeneruese në rrjetin e saj. Kjo veprimtari ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të energjisë nga burime të rinovueshme, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të sektorit energjistik në vend.

17.9 Miratimet e Pikës së Lidhjes së Burimeve Gjeneruese

Gjatë vitit 2024, sektori i burimeve gjeneruese, në përputhje me VKM Nr. 822/2015, ka dhënë gjithsej 29 miratime për lidhjen e burimeve gjeneruese të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes. Këto miratime janë shpërndarë si më poshtë:

- 8 miratime për Hidrocentrale (HEC-e)
- 19 miratime për parqe fotovoltaike (PV)
- 2 miratime për parqe eolike (EOLIKE)

Ky proces ka mundësuar integrimin e mëtejshëm të burimeve të rinovueshme në rrjetin e shpërndarjes, duke kontribuar në rritjen e kapacitetit të prodhimit të energjisë nga burime të pastra dhe të rinovueshme.

Lloji I Gjeneruesit	Numri I miratimeve	Fuqia e instaluar e gjeneruesit MW
Eolik	0	0
Fotovoltai	24	126
HEC	7	23
Totali	29	91.39

Opinionet paraprake të dhëna nga sektori i burimeve gjeneruese të ndara sipas nënstacioneve per Vitin 2024

Pika e lidhjes (zbara nst ose linje 35 kV)	Opinion paraprak	Fuqia MW
Totali	42	230

Në vitet e fundit, ndërtimi i impianteve kryesisht fotovoltaike dhe eolike ka marrë një vëmendje të madhe, sidomos për shkak të pozitës së favorshme gjeografike të Shqipërisë, që ofron mundësi të shkëlqyera për përdorimin e burimeve të rinovueshme. Ky zhvillim përbën një alternativë të rëndësishme dhe ekonomike për prodhimin e energjisë elektrike, dhe shumë projekte të tilla janë në faza realizimi. Sidoqoftë, këto impiante të rinovueshme, veçanërisht ato fotovoltaike, mund të sjellin ndikime të ndjeshme në rrjetin e shpërndarjes të energjisë, që kërkojnë një studim të thelluar dhe të mirëplanifikuar për të vlerësuar impaktin që ato mund të kenë.

Përveç kësaj, një tjetër problematikë e rëndësishme është nevoja për rifreskimin e rregullores për lidhjet e reja të burimeve gjeneruese. Kjo është e domosdoshme për të siguruar që procedurat dhe dokumentacioni që kërkohet për miratimin e pikës së lidhjes së këtyre burimeve janë në përputhje me zhvillimet e reja dhe kërkesat e sektorit të energjisë. Kjo rregullore do të mundësojë një menaxhim më të mirë të procesit të lidhjes dhe do të adresojë nevojën për përmirësimin e infrastrukturës dhe procedurave që lidhen me integrimin e impianteve të rinovueshme në rrjet.

Masat e përshtatshme, në rast nevojë të rritjes së sigurisë së furnizimit

Shoqëria OSSH SH.A. ndjek me përparësi aksesin e shpërndarjes së energjisë elektrike në mënyrë të panderprere në të gjithë përdoruesit e saj nëpërmjet rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike në përputhje me planin e masave të gadishmerise.

Nën drejtimin e OSSH sh.a e përfaqësuar nga Drejtoria e TL dhe Drejtoritë Rajonale përkatëse vijon puna e përditshme për garantimin e aksesit të shpërndarjes së energjisë elektrike, tek Përdoruesit (Konsumatore apo prodhues të energjisë elektrike) e saj me një cilësi dhe shkallë të lartë sigurie duke pasur një sistem shpërndarës të qëndrueshem.

Në këtë kuader, nga ana e OSSH SH.A. është rritur kujdesi ndaj kontroll monitorimit për zbatimin e protokolleve për paisjet e ndryshme në N/stacionet transformuese TL/TM, kabina elektrike TM/TU, dhe linjat shpërndarëse të niveleve 35/20/10/6/0.4kV ku zhvillohen kontrole dhe remonte periodike në përputhje me kërkesat e rregullores së sigurisë teknike dhe shfrytëzimit të paisjeve dhe impianteve elektrike. Për të garantuar aksesin e shpërndarjes me energji elektrike janë marrë masa nepermjet:

- Vendosijses së rregullave dhe kërkesat teknike minimale për mbajtjen e stabilitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit, të detyrueshme këto për OSSH sh.a, dhe përdoruesit e lidhur në rrjetin elektrik të shpërndarjes.
- Parandalimit të çrregullimeve të tejzgjatura në Sistemin e Shpërndarjes
- Sigurimit dhe garantimit të plote për zbatimin e normave të cilësisë së shërbimit të Shpërndarjes së energjisë elektrike

Objektivi i procesit procedurave zhvillimore është të sigurojë shpërndarjen e energjisë elektrike gjatë emergjencës energjitike ku përdoruesit do t'u sigurohet prezencë e energjisë elektrike pa asnjë lloj diskriminimi. Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike menaxhohet nga sistemi I Dispecerimit Qëndrorë e OSSH –së për nivelin TL dhe TM duke funksionuar në 24h/7d, duke nxjerrë rregullisht cdo 3 ore komunikatën për shtyp të OSSH për të bërë me dije OSHEE sh.a Group, MIE, ERE dhe cdo institucion të interesuar për mbarëvajtjen e procesit. Komunikimet midis Dispecerise Qendrore TM/TU me 11-të Dispeceritë Rajonale për marrjen e informacionit në kohë reale vazhdon në mënyrë korrekte.

Gjithashtu kompania e OSSH për shkak të emergjencës së furnizimit me energji elektrike ka ndër prioritetet e saj edhe garantimin e cilësisë së aksesit të shpërndarjes së energjisë elektrike në mënyrë të panderprere me energji elektrike në vecanti të të gjithë objekteve të rëndësise së vecante si:

- Spitalet.
- Hidrovoret.

- Objektet e rendesise se veçantë administrative, etj.
- Të gjithë konsumatorët, deri tek konsumatori me i fundit.

OSSH SH.A. për të perballuar furnizimin e pandërprere me energji Elektrike gjatë periudhes se Vitit të Ri, gjatë sezonit veror, si dhe në vazhdimësi për vitin 2024/5 ka ngritur grupet e Gadishmerise nga Drejtoria e Tensionit të Larte dhe me 11 Drejtorite Rajonale.

Gjithashtu ka krijuar dhe skenaret e mundshem për perballimin dhe menaxhimin e ngarkeses dhe kerkeses me Energji Elektrike.

Per të siguruar nje furnizim të pandërprere dhe me cilesi si dhe për të rritur sigurine e Sistemit nga ana e OSSH-së janë marrë një sërë masash tekniko-organizative.

Strategjia e Planifikimit për Realizimin e Objektivave 2025

Për realizimin e këtyre objektivave, strategjia do të fokusohet në disa drejtime kyçe:

- Identifikimi dhe mbështetje për projekte kyçe: Prioritet do t'i jepet identifikimit të projekteve që kërkojnë rritje kapaciteteve dhe përmirësim të nënstacioneve ekzistuese. Ky proces përfshin edhe investime për rikonstruksionin dhe ndërtimin e nënstacioneve të reja për të adresuar kërkesat në rritje për energji.
- Zgjerimi i rrjetit 35 kV: Për të perballuar kufizimet teknike të rrjedhjes së ngarkesës dhe për të përmirësuar cilësinë e furnizimit, do të shqyrtohet zgjerimi i rrjetit në nivelin 35 kV, ku ndërtimi i kapaciteteve 110 kV dhe daljeve të reja 20 kV është teknikisht dhe ekonomikisht i pamundur.
- Investimet në rrjetin 10 kV dhe 6 kV: Këto investime synojnë ndarjen e ngarkesave në fiderat ekzistues dhe përmirësimin e rrjetit në zona të largëta dhe rurale për të garantuar një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike.
- Përmirësimi i rrjetit TM/TU dhe kalimi në 20 kV: Ndryshimi i nivelit të tensionit nga 10 kV dhe 6 kV në 20 kV, si dhe përmirësimi i kabinave të transformimit, do të ndihmojë në uljen e humbjeve teknike dhe përmirësimin e stabilitetit të sistemit.
- Modernizimi i rrjetit të matjes: Ky plan do të përfshijë përdorimin e teknologjive të reja për matjen e energjisë dhe për reduktimin e humbjeve që mund të ndodhin për shkak të cenimeve të mundshme të sistemeve të matjes.

Bazat Ligjore

Këto investime dhe strategji janë të mbështetura nga kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi:

- Ligji Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", që rregullon çështjet kyçe të sektorit të energjisë dhe shpërndarjes në Shqipëri, duke ofruar një kornizë ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit.
- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 135, datë 06.09.2017, për "Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike", që përcakton procedurat dhe detyrimet për miratimin e investimeve të tilla

18. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRTARIT DHE REKOMANDIMET

Kjo pjesë e raportit përshkruan masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyrtari i Pajtueshmërisë në raportin e vitit 2023. Më poshtë janë detajuar disa nga këto masa dhe arritjet përkatëse:

1. **Përditësimi i faqes zyrtare të OSSH:** Ky hap është shumë i rëndësishëm, duke sjellë një bashkëpunim të ngushtë mes Administratorit të Shoqërisë OSSH dhe OSSHE, si dhe akterëve të tjerë të përfshirë në këtë proces, të cilët kanë kontribuar në krijimin e një faqeje më dinjitoze dhe më fleksibël. Faqja është ri-dizajnuar për të përmirësuar mënyrën e dhënies dhe organizimit të informacionit, duke siguruar një prezantim më të qartë dhe menaxhim të duhur të informacionit të rëndësishëm. Gjithashtu, është pajtuar me standardet e sigurisë për sistemet e informacionit në internet. Kjo masë është konsideruar e zbatuar dhe e përfunduar nga OSSH, sipas rekomandimeve nga zyrtari dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. **Vendosja e Programit të Pajtueshmërisë dhe raportit vjetor në Web të Shoqërisë:** Ky program synon të sigurojë informacion të saktë dhe të mjaftueshëm për të gjithë punonjësit e OSSH, duke i mundësuar atyre të zbatojnë Programin e Pajtueshmërisë. Ky program është zbatuar plotësisht në përputhje me kërkesat e zyrtarit dhe është publikuar në faqen zyrtare të kompanisë.
3. **Krijimi i një rubrike të re në Website OSSH - "Njofto/Raporto te Zyrtari":** Ky hap është ndërmarrë për të adresuar çështjet që lidhen me aktivitetet joetik, përfshirë konfliktin e interesit, rrjedhjen e informacionit sensitiv, trajtimin diskriminues të përdoruesve të sistemit dhe mosrespektimin e Programit të Pajtueshmërisë. Kjo mundësi është ofruar përmes një forme konfidenciale emaili. Kjo masë është zbatuar sipas kërkesës së zyrtarit që në fazën e parë të realizimit të projektit.
4. **Trajnime dhe takime/informime me stafin:** Në lidhje me këtë pikë, janë informuar dhe kanë marrë njoftime me nënshkrim nga punonjësit, si dhe janë zhvilluar trajnime dhe takime në Rajonin e Tiranës, ku janë informuar dhe këshilluar në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë. Kjo masë është realizuar në përputhje me kërkesat e zyrtarit.
5. **Miratimi i strukturës së re sipas ligjit në fuqi:** Sipas kërkesës dhe në bashkëpunim me Administratorët e kompanisë OSSHE Group/OSSH Sh.A., Këshilli Mbikëqyrës, me Vendimin Nr. 32, datë 24.06.2024, ka miratuar ndryshimin e strukturës së shoqërisë OSSH Sh.A., dhe ky informacion është publikuar në faqen zyrtare www.ossh.al.

Ky është një përmbledhje e masave dhe arritjeve të realizuara në përputhje me rekomandimet dhe kërkesat ligjore, që synojnë përmirësimin e procesit të menaxhimit dhe rritjen e transparencës dhe efikasitetit në veprimtarinë e OSSH.

18.1 Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë;

1. Hartimi dhe miratimi i Kodit të ri të Shpërndarjes:

Është thelbësore që Kodi i Shpërndarjes të miratohet dhe të zbatohet brenda këtij viti, duke siguruar që të respektohen të gjitha aktet dhe aktorët ligjorë përkatës. Ky proces duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të garantohet një zbatim i rregullt dhe i përputhshëm me kërkesat ligjore, duke kontribuar kështu në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në

menaxhimin e aktiviteteve. Po ashtu, është e rëndësishme që ky proces të jetë në përputhje me kërkesën e Sekretariatit të Energjisë, e cila është dhënë më datë 1 nëntor 2024, për të siguruar që të gjitha procedurat dhe afatet të respektohen në mënyrë të duhur.

2. Menaxhimi i Ankesave dhe Kërkesave të Konsumatorëve:

Sigurimi që çdo ankesë të trajtohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e brendshme dhe të japë rezultate të shpejta dhe të drejta për konsumatorët është një prioritet i rëndësishëm. Kjo është një pikë e fortë që OSSH ka zbatuar, dhe me strukturën e re kërkohet më shumë vëmendje dhe përmirësim në këtë aspekt për të garantuar një menaxhim sa më të efektshëm të ankesave dhe kërkesave.

3. Implementimi i Teknologjive të Avancuara për Monitorimin dhe Menaxhimin e Furnizuesve të Energjisë dhe Defekteve në Kohë Reale:

Një hap kyç për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të shpërndarjes dhe ofrimin e një shërbimi më të besueshëm për konsumatorët është implementimi i teknologjive të avancuara për monitorimin e furnizuesve të energjisë dhe identifikimin e defekteve në kohë reale. Këto teknologji do të mundësojnë identifikimin dhe raportimin e çështjeve në rrjet në të gjithë Shqipërinë dhe do të lejojnë një zgjidhje të shpejtë dhe të saktë, duke rritur qëndrueshmërinë e rrjetit dhe minimizuar ndërprerjet e panevojshme për konsumatorët.

4. Trajnimet në lidhje me Konfidencialitetin e të Dhënave dhe të Drejtën e Informimit:

Për të përmbushur parashikimet e ligjit për sektorin e energjisë dhe kërkesat e Programit të Pajtuëshmërisë për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/informacionit të ndjeshëm, është e rëndësishme të realizohen trajnime të vazhdueshme për të gjithë punonjësit e OSSH, veçanërisht për ata që kanë akses në platformat elektronike të kompanisë. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që informacionet e ndjeshme të trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë.

19. BASHKËPUNIMI ME ERE NË LIDHJE ME RAPORTIN E PAJTUESHMËRISË 2023

Ky raportim ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje të plotë të bashkëpunimit dhe korrespondencës me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) në lidhje me Raportin e Pajtuëshmërisë për vitin 2023. Në datën **21.01.2025**, ERE ka dërguar një shkresë, nr. **prot 216**, drejtuar Zyrtarit të Pajtuëshmërisë, ku theksohet se raporti është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në kontratë dhe kërkohen informacione dhe shpjegime përkatëse për vitin pasardhës.

Në vijim, për t'u përgjigjur kërkesave të ngritura, paraqiten detajet sipas pikave të mëposhtme:

a) Plotësimi i rekomandimeve në lidhje me miratimin e organigramës së re

Këshilli Mbikëqyrës, me Vendimin Nr. 32, datë 24.06.2024, ka miratuar ndryshimin e strukturës organizative të shoqërisë "OSSH" SH.A. Në këtë organigramë të re, janë bërë disa shtesa dhe përmirësime për të optimizuar menaxhimin dhe operimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në strukturën e re janë shtuar disa drejtoritë të reja dhe pozita kyçe, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e operacioneve dhe monitorimin më të detajuar të performancës dhe të dhënave të rrjetit. Këto përfshijnë:

Departamenti i Operimit të Rrjetit dhe Analizës së Performancës:

- Drejtoria e Operimit të Rrjetit: Përgjegjës për menaxhimin e operacioneve të përditshme të rrjetit të shpërndarjes, për sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.
- Drejtoria e Analizës, Përpunimit të të Dhënave të Cilësisë së Rrjetit dhe Monitorimit të Zbatimit të Kodeve dhe Marrëdhënieve Rregullatore: Fokusuar në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për cilësinë e energjisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe kodeve të përcaktuara nga autoritetet përkatëse, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e shërbimeve dhe sigurimin e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjetik:

- Drejtoria e Mbështetjes së Tregut të Energjisë: Angazhuar në menaxhimin e të dhënave të tregut dhe të gjitha aktiviteteve të lidhura me furnizimin dhe shitjen e energjisë, si dhe mbështetje për optimizimin e procedurave të tregtimit dhe bilancit të energjisë.
- Sektori i Monitorimit të Matjes Online: Përdor teknologji të avancuar për monitorimin në kohë reale të matjeve dhe të dhënave të lidhura me shpërndarjen dhe konsumimin e energjisë, duke siguruar transparencë dhe saktësi të lartë në raportimet dhe analizat energjetike.

Këto shtesa dhe ndryshime në organigramë kanë për qëllim jo vetëm riorganizimin e strukturës brenda OSSH për t'u përshtatur me zhvillimet e fundit në tregun e energjisë elektrike, por gjithashtu dhe për të optimizuar menaxhimin dhe performancën e rrjetit të shpërndarjes, si dhe për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe implementimin e standardeve rregullatore dhe të cilësisë.

Gjithashtu, këto ndryshime nuk kanë sjellë ndryshime në numrin total të punonjësve të OSSH, i cili mbetet i pandryshuar, por kanë ndikuar në mënyrën se si strukturat dhe departamentet bashkëpunojnë për të arritur efikasitet më të lartë në operacione.

b) Transparenca dhe Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit;

Gjatë vitit 2024, kam qenë plotësisht i informuar për të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Mbikëqyres, si dhe për vendimet e marra lidhur me progresin dhe aktivitetet e OSSH. Informacioni për mbledhjet dhe veprimet e ndërmarra është ndarë në mënyrë transparente, duke siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat dhe standardet e ERE-së. Përveç informacionit në mbledhje, jam gjithashtu informuar për zhvillimet dhe vendimet e mbledhjeve përmes e-mail-it, duke garantuar një komunikim të plotë dhe të hapur.

c) Pavarësia dhe Deklarata e Pavarësisë;

Sipas pikave 4 dhe 5 të programit, janë plotësuar deklaratat përkatëse nga Administratori i OSSH, ku theksoj se ka tagrat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, përfshirë dhe përgatitjen e deklaratave përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative. Ai është përgjegjës për sigurimin e menaxhimit të duhur të operacioneve dhe për ruajtjen e transparencës në aktivitete të ndryshme tregtare, të cilat dëshmojnë përpjekjet për ruajtjen e pavarësisë dhe shmangien e ndikimeve nga struktura të tjera të shoqërisë së integruar. Këto deklarata përfshijnë angazhimin për mos marrjen e kompensimeve financiare apo përfitimeve nga shoqëritë e tjera dhe për të siguruar që pagat nuk do të lidhen me performancën e kompanive të tjera.

Deklaratat përkatëse janë si më poshtë:

- Angazhohemi që nuk do të marrim pjesë në strukturat përgjegjëse të shoqërisë së integruar lidhur me veprimtarinë e saj operacionale.
- Deklarojmë se nuk do të marrim kompensim financiar ose përfitime nga shoqëritë e tjera.
- Angazhohemi që pagat nuk do të lidhen me nivelin e performancës së kompanive të tjera brenda shoqërisë së integruar.

d) Ofrimi i Shërbimeve të Përbashkëta;

Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta sigurohet nga Neni 72 i Ligjit Nr. 43/2015, i cili specifikon se këto shërbime nuk çenojnë pavarësinë organizative dhe të vendimarrjes së shoqërisë, siç kërkohet në pikën 3 të këtij neni.

Proceset Konkurruese dhe Çmimet e Tregut:

- Përqendrimi i shërbimeve të grupit në një shoqëri të veçantë ka si qëllim ofrimin e shërbimeve të specializuara, përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve, duke shfrytëzuar burimet njerëzore dhe informacionet historike që OSHEE (si shoqëri mëmë) ka trashëguar.
- Ky model mundëson uljen e shpenzimeve për njësitë e shërbimeve që do të ishin më të larta nëse shërbimet do të ishin organizuar drejtpërdrejt nga shoqëritë bijë. Shërbimet ofrohen me vlerën neto të shpenzimeve dhe **pa përfshirë fitime.**
- Modeli i marrëveshjes së shërbimeve, i zhvilluar nga KPMG në vitin 2010, është në përputhje me parimet e përputhshmërisë dhe është konsultuar me Zyrën për Reformën në Sektorin Energjitik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ky model përdoret gjithashtu në shtete të Bashkimit Europian, si Gjermani dhe Çeki, sipas konsultimeve me ekspertë të huaj.

Në këtë kuadër, procesi i prokurimit të shërbimeve të përbashkëta realizohet me kosto më të ulëta, duke plotësuar kërkesat e Programit të Pajtuëshmërisë dhe duke zbatuar në mënyrë të plotë aktet ligjore në fuqi, përfshirë Ligjin Nr. 43/2015. Kjo siguron përputhshmërinë e aktivitetit dhe mban transparencën dhe ndershmërinë në zhvillimin e procesit të prokurimit.

e) Përditësimi i Programit të Pajtuëshmërisë

Me Vendim të Bordit të ERE Nr. 257, datë 21.12.2020, Programi i Pajtuëshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sha) përcakton kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OSSH sha, në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

OSSH ka arritur të plotësojë me sukses kushtet e përcaktuara në Programin e Pajtuëshmërisë, përfshirë:

- Ndarjen dhe pavarësinë e OSSH, duke siguruar një funksionim të pavarur në përputhje me kërkesat ligjore.
- Ndarjen e llogarive, menaxhimit dhe vendimarrjes, duke siguruar që ato të realizohen sipas parimeve ligjore dhe transparente.

- Shmangien e sjelljeve diskriminuese, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë përdoruesit dhe operatorët.
- Transparencë dhe paanshmëri, duke përfshirë krijimin e një web-i të ri efikas (www.ossh.al), që siguron informacione të qarta dhe të arritshme për palët e interesuara.
- Monitorimin dhe raportimin të ERE, duke siguruar përputhshmërinë ligjore

Këto masa tregojnë se OSSH ka përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat dhe standardet përkatëse.

Në këtë kuadër, dua të theksoj se kjo çështje është raportuar nga zyrtari në përputhje me afatet dhe kërkesat ligjore. Gjithashtu, Sekretariati ka mbyllur çështjen ECS-4/17, e hapur më 16.01.2018, e cila lidhet me përmbushjen e detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Më 18.04.2023, Sekretariati e ka konsideruar çështjen të ezauruar pas traspozimit të plotë të Direktivës së Energjisë Elektrike dhe ndarjes ligjore dhe funksionale të OSSH. Masat përfundimtare për sigurimin e ndarjes funksionale përfshijnë miratimin e Programit të Pajtuashmërisë.

20. KONKLUZIONE

Në vitin 2024, Operator i Sistemit të Shpërndarjes, OSSH Sh.A., ka arritur rezultate të rëndësishme në përpjekjet për të ofruar shërbime cilësore dhe për të realizuar objektivat strategjike të Shoqërisë. Me një angazhim të vazhdueshëm dhe një menaxhim të përkushtuar, OSSH ka arritur të përmirësojë efikasitetin e rrjetit të shpërndarjes, duke ulur ndjeshëm humbjet dhe duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.

Një zhvillim kyç i vitit 2024/2025 është bashkëpunimi i ngushtë mes OSSH/OSHEE-së, Qeverisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që ka çuar në një hap të rëndësishëm për përmirësimin e kushteve për konsumatorët. Për herë të parë, është arritur të implementohet një ulje e çmimit të energjisë elektrike, e cila pritet të hyjë në fuqi në shkurt 2025. Kjo ulje do të sjellë përfitime të konsiderueshme për më shumë se 1 milion abonentë familjarë në Shqipëri. Çmimi i energjisë do të ulet nga 9.5 lekë për kilovat-orë në 8.5 lekë për kilovat-orë për konsumet deri në 700 kilovat-orë, ndërsa çmimi për konsumin mbi këtë kufi do të mbetet në 9.5 lekë për kilovat-orë.

Ky rezultat është pasojë e bashkëpunimit të frytshëm mes aktorëve kryesorë të sektorit të energjisë, përfshirë OSSH/ OSHEE, të cilët kanë demonstruar performancë të lartë në vitin 2024. Megjithatë, ky është vetëm një hap i parë në rrugën drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Sektori i energjisë vazhdon të përballet me sfida të mëdha për të arritur rezultate të tjera të rëndësishme. Për të siguruar stabilitet dhe përparim të mëtejshëm, është e nevojshme që të ruhet një nivel i lartë performancë dhe të realizohen hapa të tjerë të rëndësishëm në vitin 2025 dhe në vitet pasuese.

Raporti i vitit 2024 ka ofruar një vlerësim të hollësishëm të përputhshmërisë së Operator i Sistemit të Shpërndarjes me kërkesat e programit të pajtuashmërisë dhe ka vënë në dukje se nuk janë identifikuar shkelje të rëndësishme që mund të çonin në mosplotësimin e ndonjë prej kriterëve thelbësorë për të siguruar integritetin dhe transparencën e aktiviteteve të kompanisë. Ky raport ka vlerësuar se kompanitë e përfshira kanë respektuar në mënyrë të duhur disa aspekte kyçe, duke garantuar që

politika dhe praktikat e ndjekura janë në përputhje me rregullat dhe standardet që kërkohen për të ruajtur një sistem të drejtë dhe të paanshëm.

Në këtë kuadër, është konfirmuar se Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) i është siguruar pavarësia nga çdo ndikim i mundshëm i kompanive të tjera vertikalisht të integruara, por jo vetëm, që angazhohen në aktivitete prodhimi ose furnizimi me energji, duke mbajtur kështu një administrim të drejtë dhe të paanshëm të sistemit të shpërndarjes. Po ashtu, është theksuar se janë ruajtur në mënyrë të përshtatshme të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit të ndjeshëm tregtar, duke siguruar kështu që marrëdhëniet tregtare të kompanisë dhe konkurrenca në sektorin e energjisë janë zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të sigurt.

Një tjetër aspekt thelbësor është garantimi i trajtimit të barabartë të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, ku raporti ka vlerësuar se OSSH ka vepruar në përputhje me parimet e barazisë, pa shfaqur asnjë formë diskriminimi ndaj përdoruesve të sistemit. Ky angazhim është i rëndësishëm për të mbajtur besimin e konsumatorëve dhe për të siguruar një mjedis të drejtë dhe konkurrues për të gjitha palët e interesuara.

Në këtë kontekst, Sekretariati ka mbyllur çështjen ECS-4/17, e cila ishte hapur më 16 janar 2018, për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Më 18 prill 2023, Sekretariati e ka konsideruar çështjen të ezauruar, pas traspozimit të plotë të dispozitave të Direktivës për Energjinë Elektrike në lidhje me ndarjen e OSSH-së në legjislacionin kombëtar, përfundimit të ndarjes ligjore dhe progresit të dukshëm në realizimin e ndarjes funksionale. Po ashtu, në raportin e Sekretariatit të nëntorit 2024, është deklaruar se OSSH-ja është e ndarë ligjërisht sipas akteve ligjore të përcaktuara.

Për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e programit të pajtueshmërisë, është e nevojshme që të gjitha nivelet e menaxhimit dhe departamentet e kompanisë të bashkëpunojnë ngushtë dhe të vazhdueshëm. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm për identifikimin dhe parandalimin e çdo forme diskriminimi, për të ruajtur një klimë të besueshme dhe të drejtë në sektorin energjetik. Ky proces kërkon angazhim të lartë nga të gjithë drejtuesit, për të siguruar që politikat dhe procedurat e brendshme të jenë në përputhje me parimet e barazisë, transparencës dhe paanshmërisë.

Si përfundim, dëshiroj të theksoj bashkëpunimin jashtëzakonisht të frytshëm dhe të suksesshëm që kam pasur me të gjitha njësitë organizative të OSSH dhe OSHEE, si dhe me stafin, drejtorët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, si dhe me strukturat përkatëse të Autoritetit të Regullatorit të Energjisë (ERE) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë, OSSH Sh.A.



Tiranë, Mars 2025

Vlerësimi i Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2024

Enti Rregullator i Energjisë (ERE),

Në cilësinë e autoritetit të pavarur rregullator për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s,

Duke ushtruar funksionin mbikëqyrës dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtushmërisë nga operatorët e sistemit të shpërndarjes, në përputhje me parimet e ndarjes funksionale, ligjore dhe organizative;

Duke u mbështetur në nenin 72, pika 3, gërma “b” të ligjit nr. 43/2015 dhe në vendimin nr. 257, datë 21.12.2020 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e Programit të Pajtushmërisë së OSSH sh.a.”, sipas të cilëve Zyrtari i Pajtushmërisë është i detyruar të paraqesë çdo vit pranë ERE një raport mbi monitorimin dhe zbatimin e programit përkatës;

Duke konsideruar raportin vjetor të Zyrtarit të Pajtushmërisë të OSSH sh.a. për vitin 2024, si një dokument zyrtar që synon të informojë rregullatorin mbi masat e marra për zbatimin e detyrimeve të Programit të Pajtushmërisë dhe për sigurimin e një veprimtarie të pavarur, transparente dhe jo-diskriminuese të operatorit në treg;

Duke vlerësuar se raporti për vitin 2024 është hartuar dhe dorëzuar në përputhje me afatet dhe standardet e përcaktuara në program, është i strukturuar sipas metodologjisë së kontrollit të miratuar dhe reflekton zbatimin e shumicës së rekomandimeve të mëparshme të ERE-s;

Duke marrë parasysh përpjekjet e operatorit për garantimin e ndarjes funksionale dhe organizative, përmirësimin e transparencës, aksesueshmërisë së informacionit dhe modernizimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve;

VLERËSON

Në vijim të shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2024 në zbatim të programit të pajtushmërisë, Bordi i ERE-s konstaton:

1. Përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe institucionale për dorëzimin dhe publikimin e raportit në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të operatorit OSSH sh.a.,
2. Zbatimin e një metodologjie të strukturuar kontrolli për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, përfshirë monitorimin e proceseve vendimmarrëse të operatorit, kontratave, ankesave dhe të dhënave të raportuara nga strukturat e brendshme.
3. Ndarjen e qartë funksionale dhe organizative të OSSH sh.a. nga strukturat e integruara vertikalisht, si dhe përforcimin e pavarësisë operacionale përmes miratimit të organigramës së re dhe vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 187, datë 07.08.2025

4. Zbatimin e kërkesave të transparencës përmes përmirësimit të komunikimit publik, funksionalizimit të identitetit vizual dhe prezantimin institucional përmes logos dhe strukturimit të qartë të përmbajtjes publike, përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve inovative duke garantuar shërbime më të shpejta dhe transparente për konsumatorët, si dhe angazhimin për përmirësimin e rubrikave të informacionit publik mbi performancën dhe investimet.

REKOMANDON

Në funksion të përmirësimit të zbatimit të Programit të Pajtushmërisë, për periudhën pasardhëse (vitin 2025) Bordi i ERE-s për Zyrtarin e Pajtushmërisë të OSSH sh.a. rekomandon:

1. Fokusimi në çështjet kyçe të Programit të Pajtushmërisë. Zyrtari i Pajtushmërisë të sigurojë që raportimi vjetor të përqendrohet mbi dispozitat thelbësore të programit, të jetë i qartë, objektiv dhe të pasqyrojë drejtpërdrejt zbatimin e detyrimeve ligjore dhe rregullatore. Ky fokus të mbështesë funksionin mbikëqyrës të ERE-s dhe të garantojë një proces raportimi transparent dhe të qëndrueshëm.
2. Monitorimi i procesit të transferimit të punonjësve. Zyrtari i Pajtushmërisë të monitorojë në mënyrë të paanshme dhe të detajuar procesin e transferimit të punonjësve, duke siguruar përputhshmërinë me kuadrin ligjor për burimet njerëzore dhe me Kodin e Punës. Të vlerësohet ndikimi i këtyre lëvizjeve në paanshmërinë funksionale dhe në stabilitetin e strukturës organizative të operatorit.
3. Ruajtja e pavarësisë dhe integritetit në ushtrimin e funksionit. Zyrtari i Pajtushmërisë të vijojë të ruajë pavarësinë, integritetin profesional dhe diskrecionin në ushtrimin e funksionit, duke shmangur çdo ndikim të brendshëm që mund të cenojë objektivitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes. Kjo është e domosdoshme për të garantuar që funksioni i pajtushmërisë të ushtrohet në mënyrë efektive dhe të pavarur.
4. Monitorimi i planit të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit. Zyrtari i Pajtushmërisë të përmirësojë monitorimin mbi zbatimin e planit të investimeve dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, duke verifikuar përputhshmërinë me rregulloret përkatëse dhe me dokumentet e miratuara nga ERE. Të kërkojë informacion të plotë dhe të saktë nga operatori për çdo projekt të miratuar apo në proces zbatimi.
5. Monitorimi i projekteve për matësa dhe matësa inteligjentë. Zyrtari i Pajtushmërisë të forcojë kontrollin dhe raportimin mbi projektet e matësive dhe matësive inteligjentë, duke përmirësuar mekanizmat e monitorimit dhe duke raportuar në periudhën pasardhëse mbi procesin dhe statusin e këtyre projekteve, përfshirë nivelin e mbulimit të tyre në rrjet. Raportimi duhet të jetë në përputhje me planet dhe strategjitë e shoqërisë, të implementuara apo të planifikuara për implementim, si dhe të shoqërohet me një vlerësim të plotë të pajtushmërisë me strategjinë afatmesme të zhvillimit të operatorit dhe objektivat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit.

Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 187, datë 07.08.2025

6. Monitorimi i procedurave të ndërrimit të furnizuesit. Zyrtari i Pajtueshmërisë të përforcojë mekanizmat e kontrollit mbi procedurat e ndërrimit të furnizuesit, duke garantuar zbatimin e drejtë dhe transparent të kërkesave të paraqitura nga konsumatorët. Në raportin e ardhshëm të pasqyrohen në mënyrë të qartë kërkesat e trajtuara, ankesat e evidentuara dhe përputhshmëria me dispozitat e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.”.
7. Raportimi mbi Kodin e ri të Shpërndarjes. Zyrtari i Pajtueshmërisë të raportojë mbi statusin e procesit të finalizimit të “Kodit të ri të Shpërndarjes”, duke ndjekur afatet e deklaruara për përfundimin dhe miratimin e tij në dhjetor 2025. Raportimi të përfshijë gjithashtu analizën mbi ndikimin e këtij kodi në përmbushjen e objektivave të ndarjes funksionale të operatorit.
8. Monitorimi i platformës për menaxhimin e furnizuesve. Zyrtari i Pajtueshmërisë të mbajë në monitorim dhe të raportojë mbi funksionalitetin e platformës për menaxhimin e furnizuesve, e cila sipas deklarimeve duhet të jetë operationale nga muaji korrik 2025. Në raportim të verifikohet nëse kjo platformë është shoqëruar me dokumentacion të brendshëm rregulator, procedura të kontrollit, si dhe mekanizma për raportimin e transparencës dhe të performancës së saj.
9. Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve për sigurinë kibernetike. Zyrtari i Pajtueshmërisë të vijojë të monitorojë përmbushjen e detyrimeve në përputhje me “Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 126/2020, i ndryshuar me vendimin nr. 79, datë 14.04.2025, dhe të raportojë mbi masat konkrete të ndërmarra nga operatori në këtë drejtim.
10. Raportimi mbi burimet vetëprodhuese dhe gjeneruese. Zyrtari i Pajtueshmërisë të përfshijë në raportimin vjetor informacion të detajuar mbi burimet vetëprodhëse të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, duke paraqitur fuqinë e instaluar sipas rajoneve, sasinë e energjisë së prodhuar dhe konsumuar, si dhe ndikimin e tyre në ngarkesën neto të rrjetit. Ky vlerësim shërben për analizimin e sfidave që lidhen me integrimin efektiv dhe të drejtë të këtyre burimeve në sistemin e shpërndarjes.

Miratuar më datë: 07.08.2025